

**RRJETËZIMI
DHE ADVOKIM**
PËR AKSIONE KOMUNITARE
TE RUAJTJES SE BURIMEVE
NATyroRE LOKALE



UDHËZUES

PËR LEGJISLACIONIN MJEDISOR, METODOLOGJINË WATCH-DOG
DHE STRATEGJINË E ADVOKIMIT
NË MBËSHTETJE TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS

UDHËZUES

PËR LEGJISLACIONIN MJEDISOR, METODOLOGJINË WATCH-DOG
DHE STRATEGJINË E ADVOKIMIT
NË MBËSHTETJE TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

UDHËZUES PËR LEGJISLACIONIN MJEDISOR, METODOLOGJINË WATCH-DOG DHE STRATEGJINË E ADVOKIMIT NË MBËSHTETJE TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS

Kjo përmbledhje e dokumenteve është përgatitur në kuadër të projektit "Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale", me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky dokumentacion i përmbledhur u vjen në ndihmë Organizatave të Shoqërisë Civile dhe rrjetëzimeve lokale dhe do të shërbejë si bazë për të përgatitur programe vlerësimi/monitorimi pas prioritizimit të problematikave kryesore të identifikuara si më të nevojshme mjedisore, për t'u adresuar në organet përgjegjëse në nivel lokal, duke dhënë një modul mbështetës të praktikave dhe mjeteve të nevojshme.

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e INCA dhe autorëve, si dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1rë, Tiranë

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: info@inca-al.org

Copyright © **Instituti për Ruajtjen e Natyrës - Shqipëri (INCA)**, 2022

Të gjitha të drejtat për publikimin, shumëfishimin, kopjimin, përdorimin e informacioneve të plota apo të pjesshme janë të rezervuara nga INCA.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e **LëvizAlbania dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)**.

Tiranë, Korrik 2022



4	PARATHËNIE
7	KAPITULLI 1 – LEGJISLACIONI MJEDISOR NË MBËSHTETJE TË DETYRAVE TË NJËSIVE VENDORE
8	KAPITULLI 1 – LEGJISLACIONI MJEDISOR NË MBËSHTETJE TË DETYRAVE TË NJËSIVE VENDORE
11	1. LEGJISLACIONI PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NATYRËS NË PAJTIM ME KËRKESAT E BE-së
11	Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
11	Ligj nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
11	Ligj nr. 91, datë 28.02.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
12	Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
13	Ligj nr.10006, datë 23.10.2008“Për mbrojtjen e faunës së egër”.
15	Ligj nr.10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”.
23	KAPITULLI II - RRETH MBIKËQYRJES (WATCH-DOGGING)
24	KAPITULLI II - RRETH MBIKËQYRJES (WATCH-DOGGING)
25	2.1. ÇFARË ËSHTË NJË WATCH-DOG (QEN ROJE)?
27	2.2. GAZETARIA INVESTIGATIVE DHE ROLI MBIKËQYRËS I SAJ
27	2.3. ÇFARË ËSHTË TRANSPARENCA?
28	2.4. PESË QASJE STRATEGJIKE PËR MBIKËQYRËSIT LOKALË
28	2.4.1. HAPI I PARË: ÇAKTONI TEMATIKËN/ÇËSHTJEN QË DONI TË MBIKËQYRNI.
29	2.4.2. HAPI I DYTË: ANALIZONI TEMATIKËN.
30	2.4.3. HAPI I TRETË: KËRKIMI I TË DHËNAVE.
30	2.4.4. HAPI I KATËRT: VENDONI SE ÇFARË DO TË BËNI ME INFORMACIONIN E GRUMBULLUAR.
33	2.4.5. HAPI I PESTË: VAZHDIMI I MBIKËQYRJES PËR NJË KOHË TË GJATË.
33	KAPITULLI III – ZHVILLIMI I STRATEGJISË SË ADVOKIMIT/LOBIMIT
34	KAPITULLI III – ZHVILLIMI I STRATEGJISË SË ADVOKIMIT/LOBIMIT
35	3.1. Çfarë është advokacia
35	3.2. Hapat e veprimit për advokim
39	3.3. Lobimi, ndryshimi nga advokacia dhe mjetet për realizimin e tij
41	KAPITULLI IV – ADVOKIMI ME MBËSHTETJEN E MEDIAVE
47	KAPITULLI V - PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS {STRUKTURA}
56	DOKUMENTA TË KËSHILLUAR

PARATHËNIE

Udhëzuesi është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Projekti synon të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në nivel lokal dhe kombëtar; të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive, fuqizimit të rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC-ve) dhe partneritetin mes tyre për ruajtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore lokale.

Njëherazi, të rrisë dhe përmirësojë aftësitë e OShC-ve në angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatik për analizimin, monitorimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore, nëpërmjet aktiviteteve advokuese/lobuese të OShC-ve, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimit të ndikimeve negative në keq menaxhimin e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura mjedisore (ZMM), duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes së përgjegjshme që ndikon në miradministrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore lokale.

Po kështu, kjo nismë synon të inkurajojë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, mediave për bashkëpunimin dhe krijimin e partneritetit mes tyre, në programe pune afatgjatë për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale.

Qëllimi kryesor i udhëzuesit është të rrisë njohuritë e OShC-ve në lidhje me legjislacionin mjedisor në të cilin janë përcaktuar dhe detyrat e deleguara të qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit në territorin e bashkive, si dhe në zbatim të planeve zhvillimore, me hapat e realizimit të mbikëqyrjes/vigjilencës (ëatch-dogging) mjedisore në praktikë dhe të nxisë bashkëpunimin e një rrjetëzimi jo formal, për të realizuar vlerësimin dhe monitorimin e problematikave mjedisore në nivel lokal.

Udhëzuesi u përgatit pas një procesi të gjerë konsultimesh të koordinuar nga INCA dhe partnerët e projektit me organizatat lokale, institucioneve publike, përfaqësues të bashkive, biznesit, arsimit, ekspertë të fushës, etj. Kjo qasje, me pjesëmarrje të gjerë, mundësoi dhënien e ndihmës konstruktive gjë që ka kontribuar përmes shfrytëzimit të këndvështrimeve të ndryshme, përmes njohurive dhe përvojave të ndryshme në fushën e ruajtjes së mjedisit, natyrës dhe të përdorimit të burimeve natyrore.

Të gjitha organizatat partnere të rrjetit dhe jo vetëm, edhe pse kanë njohuri dhe kanë zhvilluar aktivitete në mbrojtje të çështjeve mjedisore, janë të informuara pjesërisht dhe nuk kanë dijet e duhura për të realizuar një proces bashkëpunimi me qeverisjen vendore dhe institucionet përgjegjëse lokale apo qendrore, për zbatimin e legjislacionit mjedisor në mbrojtje të burimeve natyrore, mbikëqyrjen/vëzhgimin mjedisor, me procedurat e informimit të publikut dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të tij në shqyrtim të çështjeve mjedisore dhe në vendimmarrjen e përbashkët.

Përdoruesit e këtij udhëzuesi duhet të kuptojnë se nuk është vetëm një manual orientues vlerësimi, por një manual i njohurive të legjislacionit respektiv që lidhet me çështjet mjedisore në nivel lokal dhe jo vetëm, me mbikëqyrjen dhe se si duhet bërë vëzhgimi mjedisor në të gjitha rrethanat e mundshme, në nivel komuniteti (vendor apo kombëtar), dhe me procesin e transparencës dhe përfshirjes në vendimmarrje në çështje

me interes publik.


Gjithashtu, udhëzuesi, ndihmon se si duhet t'i adresoni sfidat me të cilat do të përballeni në kërkimin e ndryshimeve që dëshironi; në rritjen e pjesëmarrjes në forume të ndryshme vendimmarrëse apo këshillimore, duke synuar përmirësimin e vendimmarrjes lokale për përdorimin e burimeve natyrore mbështetur në planet vendore të zhvillimit; rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përcaktimi më i mirë i rolit të gjithë aktorëve në nivel vendor në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve vendore të mjedisit.

Pra, udhëzuesi është zhvilluar duke marrë parasysh realitetin e bashkive (mbështetur në eksperiencat në zonat pilote dhe nga zbatimi i projekteve të ngjashme në bashki të tjera). Në këtë mënyrë si një mjet i dobishëm për vëzhguesit që dëshirojnë të hetojnë, analizojnë, vlerësojnë, ndërtojnë njohuri dhe edukojnë të tjerët mbi sukseset, sfidat dhe mësimet të zbatueshme për aktivitetet e tjera, synon të ndryshojë praktikatat negative, të cilat dëmtojnë gjendjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore në nivel lokal.



KAPITULLI

I



LEGJISLACIONI MJEDISOR
NË MBËSHTETJE TË
DETYRAVE TË NJËSIVE
VENDORE

KAPITULLI 1 – LEGJISLACIONI MJEDISOR NË MBËSHTETJE TË DETYRAVE TË NJËSIVE VENDORE

Qëllimi është analiza e hollësishme e kornizave kombëtare rregullatore që qeverisin pjesëmarrjen e publikut, të drejtën për informim dhe luftimin e korrupsionit në përdorimin e burimeve natyrore dhe ZMM-ve si dhe procesin e menaxhimit të tyre. Përmes kësaj analize identifikohen dhe përshkruhen roli dhe rëndësia relative e palëve të përfshira dhe veçanërisht të OShC-ve dhe rrjetëzimeve të tyre lokale, në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor e rregullator të OShC-ve, dhe aktorëve lokalë në qeverisjen vendore.

Gjithashtu, procesi i vlerësimit dhe analizimit do të mundësojë vlerësimin e nevojave dhe nxitjen e një bashkëpunimi sa më efektiv mes shoqërisë civile dhe strukturave në nivel lokal të qeverisjes vendore si dhe partneritetin mes tyre në nisma dhe aktivitete të përbashkëta që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve negative mjedisore. Kësisoj edhe promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe vlerave të biodiversitetit.


Gjatë këtij procesi vlerësim/analizimi duhet punuar për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore mjedisore dhe për burimet natyrore me të cilat përballen zonat e përzgjedhura dhe që mund të jenë pjesë e procesit të vlerësimit. Vlerësimi i situatës aktuale duhet të jetë rezultat i takimeve dhe i investigimeve në terren të organizuara me përfaqësues komuniteteve, kryepleqtë, administratorët e njësive administrative, të bizneseve, shkollat, OJF-ve mjedisore, administratat vendore, me përdorues e përfitues të burimeve natyrore, etj. Nëpërmjet këtyre takimeve duhet të sigurohet një pamje e përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në zonat pilote, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazhe, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik. Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit do të synohet që të arrihet qëllimi për reagimin ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e ndikimeve negative.

Përmes analizës identifikohen dhe përshkruhet roli dhe rëndësia e palëve të përfshira, veçanërisht të OShC-ve dhe rrjetëzimeve të tyre lokale, në njohjen dhe kuptimin e kuadrit ligjor e rregullator të OShC-ve dhe aktorëve lokalë.

Ky dokument do të jetë një mjet për OShC-të për të organizuar lobimin e tyre tek autoritetet publike dhe një informim shtesë në njohjen dhe zbatimin e kornizave kombëtare të legjislacionit për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe të ZMM, të drejta e aksesit në informacion, drejtësia mjedisore, krimi mjedisor dhe të legjislacionit tjetër përkatës, në pajtueshmëri me kërkesat e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Shqipëria ka legjislacionin e saj të ri mjedisor. Ky legjislacion bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shumica dërrmuese e ligjeve të propozuara në Kuvend vijnë nga Qeveria. Ministritë zhvillojnë prioritetet e tyre legjislative të vitit të ardhshëm, që miratohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Hierarkia e normave ligjore konsiston në:



Edhe baza ligjore për mbrojtjen e natyrës buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (**FIZ nr. 28/1998**).

Neni 59, i Kushtetutës thekson se: "Shteti synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, dhe **shfrytëzimin racional të burimeve natyrore** mbi bazën e **parimit të zhvillimit të qëndrueshëm**". Neni 56, i Kushtetutës thekson se: "Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij". Dispozitat kushtetuese theksojnë se:

- **Mjedisi dhe mbrojtja e tij, konsiderohen si qëllimet themelore të shtetit;**

Thelbi i mbrojtjes së mjedisit **është ruajtja e vazhdueshme e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm;**

- Mbrojtja e mjedisit **është një detyrë e përhershme në çdo kohë dhe në çdo rrethanë** dhe ka lidhje direkte me jetën dhe shëndetin e popullatës;
- **Zhvillimi i qëndrueshëm është një kërkesë themelore** dhe në këtë mënyrë Kushtetuta garanton mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- Publiku ka të **drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit** dhe institucionet shtetërore janë të detyruara të informojnë publikun në lidhje me mjedisin dhe masat e marra për mbrojtjen e tij.

Kodi Civil në një kapitull të veçantë "Detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit", parashikon: Personi i cili, gabimisht, **karrezikuar mjedisin, e kapërkeqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, plotësisht ose pjesërisht, është i detyruar të kompensojë dëmin e shkaktuar.**


Kohët e fundit ndryshimet e fundit në Kodin Penal mundësuan integrimin e një kapitulli të ri specifik për **krimet kundër mjedisit**. Megjithëse nuk është një kapitull shumë i përfunduar, ai është një rrugë përpara për fillimin e një procesi të ri me sanksione dhe dënime ndërsa kryhen krime kundër mjedisit. Në këtë kapitull **ndotja e ajrit, e ujërave i pyjeve dhe e tokës, menaxhimi i mbetjeve, dëmtimi dhe tregtimi i specieve të mbrojtura të florës e faunës së egër, dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore, peshkimi i paligjshëm**, etj. janë tani pjesë e këtij kapitulli.

Në përgjithësi legjislacionit mjedisor në Shqipëri, është frymëzuar dukshëm nga standartet e BE-së, ku parimet kryesore mbi mjedisin janë përfshirë, në legjislacionin shqiptar.

Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "**Për mbrojtjen e mjedisit**" hodhi themelet për

një legjislacion mjedisor bashkëkohor. Në krahasim me ligjin “Mbrojtja e mjedisit” (1993), plotësohen kërkesat kushtetuese për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm, përdorimit racional të pasurisë natyrore, parandalimi dhe kontrolli i ndotjes. Mbrojtja e natyrës dhe parimet e përgjithshme, garantojnë edhe nëpërmjet ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku është përcaktuar se “ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike” është një prej elementeve të mjedisit. Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektorë që lidhen me biodiversitetin, të tilla si: bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Korniza ligjore për mbrojtjen e natyrës përbëhet nga të gjitha nivelet dhe tipet e ligjeve dhe akteve normative.

Ky legjislacion është përgjithësisht i përqsur me standardet e BE-së dhe ndërkombëtar, sepse mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.



Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore në RSh, nga të cilat, më kryesoret, përshkruhen më poshtë. Për të siguruar zbatimin e këtyre ligjeve, janë hartuar një numër aktesh nënligjore për të plotësuar bazën ligjore për elementet specifike të mbrojtjes së natyrës.

Megjithë përpjekjet e bërë në kornizën ligjore, në aspektin e mbrojtjes së natyrës dhe shumëllojshmërisë biologjike e peizazhore, duhet të pranojmë, se ka ende boshllëqe në plotësimin dhe zbatimin e tyre. Kjo situatë ka krijuar konfuzion edhe në lidhje me vendosjen e përgjegjësive dhe kompetencave përkatëse. Të drejtat mjedisore përfshihen në kategorinë e të drejtave ku institucionet shtetërore kanë detyrimin të veprojnë për të garantuar një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Autoritetet publike (qendrore e lokale) marrin shpesh vendime që mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis si dhe në shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve, prandaj duhet të kenë gjithmonë në konsideratë detyrimin kushtetues për një mjedis të shëndetshëm.

LEGJISLACIONI PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NATYRËS NË PAJTIM ME KËRKESAT E BE-së

Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". (FIZ.nr.89/2011), ndryshuar me ligjin nr. 31, datë 14.02.2013 (FIZ. nr.30/2013).

Qëllimi i ligjit është mbrojtja, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Gjithashtu, përcaktohen parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për **garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit** në RSh. Objektivat janë: **a.parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera** të çdo lloji; **b.ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;** c.ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë **mjedisore me pjesëmarrje publike;** **ç) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;** d.**ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;** dh) **mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;** e.mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ligj nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

(FIZ nr.101/2011), ndryshuar me ligjin nr.12, datë 26.02.2015.(FIZ. nr.38/2015) dhe ligjin nr.128/20202.

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e RSh, të projekteve të propozuara, private apo publike.

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejt ose jo, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

Ligj përcakton **parimet e përgjithshme të vlerësimit të efekteve mjedisore të projekteve publike dhe private që ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis.**

Gjithashtu, përcaktohen **kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve negative në mjedis,** për të gjitha projektet e propozuara private ose publike, të cilët ka të ngjarë të prodhojnë efekte negative në mjedis.

Ligji përshkruan në **një aneks të gjitha aktivitetet specifike** që duhet t'i nënshtrohen VNM-së së thellë (Shtojca I) dhe kërkon **përfshirjen e të gjitha palëve** në procesin e VNM, **publikun dhe OJF-të pa ndonjë kualifikim specifik.**

AKM ka detyrë të zhvillojë për çdo projekt një seancë **dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara** në mënyrë që të përfshinte mendimin e tyre në vendimarrjen përfundimtare.

Dëgjesat duhet të **kryhen në bashkëpunim me autoritetet përkatëse lokale** dhe zhvilluesit e projekteve. **Autoritetet lokale,** si dhe zhvilluesit/propozuesit duhet **të njoftojnë publikun dhe OJF-të e interesuara** për datën, kohën dhe vendin e seancës.

Ligj nr. 91, datë 28.02.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”

(FIZ nr.36, datë 19 Mars 2013)

Qëllimi i ligjit është të sigurojë **mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm**, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis.

Përcakton institucionet dhe **të drejtat e përgjegjësitë e tyre**, si dhe procedurat, sipas të cilave kryhet VSM, për hartimin apo ndryshimin, rishikimin ose modifikimin **e planeve a programeve sektoriale** që sigurojnë integrimin e **parimeve të mbrojtjes së mjedisit** që në fazën e hartimit të këtyre dokumenteve.

Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

(FIZ.nr.84/206), ndryshuar me ligjin nr.37, datë 14.02.2013 (FIZ.nr.30/2013) dhe ligji nr.68, datë 03.07.2014 (FIZ nr.115/2014)

Konsiderohet ligji bazë për ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në Shqipëri. Ka për qëllim të sigurojë **mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik** si dhe të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Dipozitat e ligjit përfshijnë: a) të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të RSh, pronë shtetërore apo private; b) të gjithë përbërësit e diversitetit biologjik; c) organet shtetërore, që veprojnë në kuadër të këtij ligji apo të ligjeve të tjera të kësaj fushe, nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj, veprimtaritë e të cilëve kanë ndikim në biodiversitet, si dhe nga organizatat shoqërore dhe nga publiku.

Për të **ruajtur ekosistemet, habitatet dhe peizazhet**, kur ndodhen jashtë rrejtit përfaqësues të ZM, pronë publike apo private, përcaktohen masat duke identifikuar kategoritë e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, përfshijnë ligatinat dhe zonat e tjera me ndjeshmëri të lartë mjedisore, që identifikohen për të marrë një status të përshtatshëm ruajtjeje.

MTM dhe MB, në bashkëpunim me **organe të tjera shtetërore dhe vendore, me OShC-t, persona juridikë dhe fizikë, hartojnë planet e menaxhimit, për të mbajtur apo rivendosur statusin e favorshëm të ruajtjes së ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, veçanërisht të mbrojtura dhe me interes për komunitetin.**

Ligj nr.81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura” (FIZ. nr.166/2017).

Është ligji bazë i Sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (SZMM) në Shqipëri. Ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të ZM dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizik/juridik privat për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të ZM.

Menaxhimi e ruajtja e ZMM realizohet nëpërmjet parimeve: a) Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm; b) Parimi i integritimit; c) Parimi “ndotësi paguan”; ç) Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake.

Shpallja e Zonave të Mbrojtura përcakton: - Identifikimi dhe administrimi i ZM bëhen në përputhje me Planin Specifik të ZM dhe dokumente të tjera strategjike të fushës së mbrojtjes së natyrës; - ZMM shpallen me VKM, ku përcaktohen emërtimi, kategoria, sipërfaqja, institucioni menaxhues, objektivat e ruajtjes së zonës dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave; - Shpallja e një ZMM bëhet pas marrjes së mendimit të institucioneve akademike e shkencore në vend, **të bashkisë**, të **shoqërisë civile** dhe ekspertë të fushës, të **komunitetit të zonës** dhe të pronarëve privatë, pronat e të cilëve do të përfshihen në ZMM.

Bashkitë zbatojnë kërkesat e ligjit nr.81/2017 dhe të **ligjeve të tyre organike**, në lidhje me ZM dhe bashkëpunojnë me AKZM dhe AdZM përkatëse.

Ligj nr.10006, datë 23.10.2008

“Për mbrojtjen e faunës së egër”.

(FIZ. nr.168/2008), ndryshuar me ligjin nr.41, datë 14.02.2013 (FIZ. Nr.30/2013) dhe ligjin 46, datë 18.07.2019 (FIZ nr.111/2019).

Ligji emërtohet **“Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”** dhe ka për qëllim konservimin e faunës së egër, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj, me synimin për të siguruar llojet, popullatat, habitatet, ku kjo faunë e egër jeton, si dhe për të plotësuar kërkesat e saj për ushqim, strehim e shumim, duke siguruar, në të njëjtën kohë, edhe rrugët e saj të shtegimit, përfshirë vezët, foletë, të vegjlit dhe habitatet ku jetojnë të lira, përgjithmonë ose përkohësisht, në mjedis natyror, tokësor e ujor, në territorin e RSh.

Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, **njësitë e vetëqeverisjes vendore**, institute të specializuara, **OJF-t dhe** me persona fizikë e juridikë, harton **planet e veprimit për ruajtjen e llojeve** të kërcënuara dhe endemike. Në raste fatkeqësish natyrore, në zjarre, ngrica, përmytje, strukturat menaxhuese të pyjeve e kullotave, **organet e qeverisjes vendore, universitetet e qendrat kërkimore-shkencore dhe OJF-të hartojnë dhe zbatojnë programe e projekte përkujdesjeje për faunën e egër**, duke u siguruar strehim, ushqim dhe mjekim individëve të dëmtuar.

Ligj Nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”

(FIZ.nr.96/2020)

Qëllimi i ligjit është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Dispozitat e ligjit përfshin rregullimin e administrimit të sektorit të pyjeve, organizimin institucional, rregullimin për përfitimet dhe shërbimet ndaj tij, për bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të angazhimeve ndërkombëtare ku RSh është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore në interes të të gjithë shoqërisë.

Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.

Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

Bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor. Inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.

Bashkitë dhe AKZM janë përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në FKP, që kanë nën administrim. Për fondin pyjor privat kjo infrastrukturë ndërtohet nga pronarët.

AKP, në bashkëpunim me bashkitë, AKZM, mbikëqyr ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në pyje, ofron mbështetje teknike dhe financiare kur investimet në infrastrukturë realizohen me financimet e buxhetit të shtetit.

Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe AKZM vlerësojnë **shërbimet e ekosistemit**, që mundësojnë pyjet nën përgjegjësinë e tyre, si përfitime që njerëzit marrin prej pyjeve.

Veprimtaritë e shfrytëzimit në FKP, kur kryhen nga **strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki**, dhe **nga banorët apo pronarët** për nevojat e tyre, mund të realizohen vetëm nga individë apo subjekte të licencuara.

Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të FPK bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga **kryetari i bashkisë dhe organi përgjegjës për ZMM**. Gjithashtu, dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore dhe nga legjislacionin për bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore dhe në mbështetje të kriterëve dhe kontigjentëve të caktuar nga ministria.

Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, mbi bazën e planifikimit dhe të lejeve që lëshon për subjektet grumbulluese pyjore jodrusore (përfshirë bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore) transportohen dhe shiten pasi të jenë pajisur me certifikatë origjine.

Ligj nr.10253, datë 11.03.2010 “Për gjuetinë”.

(Flet.Zyrtare nr.39/2010), ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013 (FIZ. nr.30/2013).

Ligji ka si qëllim: a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre.

Ligj nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”.

(FIZ. nr.36/2007), ndryshuar me ligjin nr.14, datë 16.02.2012 (FIZ, nr.14/2012), ligjin

nr.38, datë 14.02.2013 (FIZ. nr.30/2013) dhe ligjin nr.49, datë 05.05.2016 (FIZ. nr. 92/2016).

Ligji synon të sigurojë një trajtim bashkëkohor të kullotave dhe livadheve, përcaktimin e kapacitetit dhe ruajtjen e balancës ekologjike të fondit të kullotave, nëpërmjet unifikimit të kërkesave dhe rregullave që lidhen me marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e shtetit, dhe institucionet lokale, organizatat kërkimore shkencore të specializuara, pronarët privatë dhe bizneset.

Fondi kullosor është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të ligjit dhe përmbledh: a) kullotat dhe livadhet; b) sipërfaqet pyjore me drurë e shkurre, që shërbejnë si kullota; c) bimësinë barishtore, drurët, shkurret e bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, natyrore, që rriten në kullota e livadhe; ç) infrastrukturën e kullotave; d) sipërfaqet shkëmbore apo moçalore në përbërje të kullotave.

Fondi kullosor ndahet në: a) fond kullosor shtetëror, në **pronësi të bashkisë**; b) fond kullosor privat, në pronësi private.

Kullotat dhe livadhet trajtohen dhe përdoren në përputhje me **planet e mbarështimit dhe të inventarizimit**, që hartohen nga **strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave, njësitë e qeverisjes vendore, pronarët privatë** për një periudhë 10-vjeçare.

Ligj nr.10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”.

(FIZ. nr.62/2009), ndryshuar me ligjin nr.42, datë 14.02.2013 (FIZ.nr.30/2013).

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, që rriten në territorin e RSh, duke zbatuar masa mbrojtëse e administruese për këto lloje bimësh; duke respektuar kërkesat teknike për vjeljen e mbledhjen e tyre; duke nxitur e përkrahur veprimtaritë për rehabilitimin e për kultivimin e tyre.

Pronësia mbi BMET-të buron nga pronësia e tokës, ku ato rriten e zhvillohen dhe njësohen me të: a) llojet që rriten në pronë **shtetërore**; b) llojet, që rriten në pyjet e kullotat **bashkiake**; c) llojet, që rriten në pyje e kullota pronë **private**.

Ligj nr.64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.

(FIZ. nr.73/2012)¹, ndryshuar me ligjin nr.80, datë 04.05.2017 (FIZ.nr.114/2017) dhe ligjin nr.4, datë 07.02.2019² (FIZ.nr.21/2019).

Qëllimi: a) sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme dhe detare të RSh; b) përcaktimin e rregullave për bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit, nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes; c) përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme; ç) nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të të dhënave në peshkim; d) sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit; dh) hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut

dhe rritjen e vlerës së prodhimit; e) përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikën evropiane në këtë drejtim; ë) ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Ligj nr.9867, datë 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër” (CITES).

(FIZ. nr.18/2008), ndryshuar me ligjin nr.5, datë 05.04.2015 (FIZ. nr. 31/2015), ligjin nr.15, datë 05.04.2018 (FLZ, nr.59/2018).

Ligji përcakton rregullat dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të konventës “Për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të florës dhe të faunës së egër”, në mënyrë që tregtia e tyre ndërkombëtare të mos ua rrezikojë mbijetesën dhe të shmangë keqtrajtjet e tyre gjatë tregtimit ndërkombëtar.

Ligji zbatohet për llojet e faunës dhe të florës, të listuara në anekset e konventës, si dhe për ato të listuara në listën vendase, ku përfshihen llojet e faunës dhe të florës vendase, të cilat miratohen me urdhër të ministrit.

Ligji nr.111, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

(FIZ. nr.111/2012), ndryshuar me ligjin nr.8, datë 08.02.2018 (FIZ.nr.30/2018)

Qëllimi: a) **mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;** b) sigurimin, **ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore,** të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) **shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit** dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) **mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike;** d) **përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor,** për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Ligj Nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”.

(FIZ. Nr.29/2002), ndryshuar me ligjin nr.10137, datë 12.06.2009 (FIZ nr.86/2009), ligjin nr.30, datë 14.02.2013 (FIZ nr.30/2013).

Ligji ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të RSh nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

Mbrojtja e mjedisit detar është detyrë e të gjitha organeve **shtetërore qendrore dhe vendore** të cilët e kanë nën administrim, **organizatat shoqërore dhe personat fizikë apo juridikë privat** ose shtetëror që e përdorin ose shfrytëzojnë kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e mjedisit detar, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimeve.

Ligj nr.93, datë 27.07.2015 “Për turizmin”.

(FIZ. nr.164/2015), ndryshuar me ligjin nr.114, datë 18.12.2017 (FIZ.nr.232/2017) dhe ligjin nr.101, datë 13.12.2018 (FIZ.nr.181/2018).

Qëllimi i ligjit është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

Dispozitat e ligjit parashtrajnë: Rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj; Rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të ndërveprimit të **organeve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore**; Përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit; dhe Rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë.

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike, për shndërrimin e tyre në produkte turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Ligj nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

(FIZ. nr.148/2011), ndryshuar me ligjin nr.32, datë 14.02.2013 (FIZ.nr.30/2013) dhe ligjin nr.156, datë 10.10.2013 (FIZ.nr.172/2013).

Ligji ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetit e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet: a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre; c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Me “menaxhim të integruar të mbetjeve” kuptohet grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi ose riciklimin mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve duhet bërë duke mbajtur në konsideratë sigurinë e shëndetit të njeriut dhe **mbrojtjes së mjedisit**, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos: a) duke mos vënë në rrezik **ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët**; b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë; c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes **zhurmave ose erërave**.

Çdo qark harton **planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve**, në përputhje me PKMIMb dhe me kërkesat e ligjit.

Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive.

Këto **rregulla** mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në PKMIMb dhe miratohen nga **Këshilli i Qarkut (KQ)**, dhe dërgon për shqyrtim dhe miratim në KM planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve. **Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve** që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Ligj nr.107, datë 31.07.2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

(FIZ. nr.137/2014), ndryshuar me ligjin nr.73, datë 09.07.2015 (FIZ.nr.126/2015), ligjin nr.28, datë 23.03.2017 (FIZ.nr. 75/2017) dhe ligji nr.42, datë 04.07.2019 (FIZ. nr.128/2019).

Qëllimi: a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet **përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore**; b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të **balancimit të burimeve natyrore**, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për: i) **mbrojtjen e burimeve natyrore**, si: toka, në veçanti **toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet**; ...; c) të nxitë veprimet e duhura **për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore** e kulturore dhe **për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit**; ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas **legjislacionit mjedisor në fuqi**; ...; dh) të sigurojë që autoritetet **kombëtare e vendore të planifikimit** të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale; e) të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit.

Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit janë: 1. Në nivel qendror: a) Këshilli i Ministrave (KM); b) Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT); c) ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; 2. Në nivel qarku: a) Këshilli i qarkut (KQ); 3. Në nivel bashkie: a) Këshilli bashkiak (KB); b) Kryetari i bashkisë.

Ligji përcakton dhe përgjegjësitë e KM, të KKT, të ministrive të linjës për planifikimin dhe zhvillimin të territorit, të AKPT, të **Këshillit të Qarkut**, i cili është përgjegjës për koordinimin e proceseve të planifikimit në **nivel qarku dhe të Këshillit bashkiak**. Përgjegjësi janë përcaktuar dhe për **Kryetarin e bashkisë**.

Ligj nr. 139, datë 17.12. 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

(FIZ nr. 249, dt 31.12.2015), ndryshuar me ligjin nr. 38, datë 20.6.2019.

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Misioni i vetëqeverisjes vendore, siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. **Parimet themelore** të vetëqeverisjes vendore, veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe respektojnë e zbatojnë **Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore**.

Në dispozitat e ligjit përcaktohen **Funksionet e bashkive**: në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike; në fushën e shërbimeve sociale; në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; në **fushën e mbrojtjes së mjedisit** si: 1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja**. 2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për **mbrojtjen nga ndotja akustike**. 3. **Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese**, në nivel vendor, të cilat lidhen me **mbrojtjen e mjedisit**. 4. **Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit**. **Po ashtu Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit** si; 1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre. 2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., 3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural,. 4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor. 5. **Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik**,. 6. **Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi**.

Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

(FIZ.nr.2/1995), ndryshuar me: Ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr.8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr.10186, datë 05.11.2009; nr.10440, date 07.07.2012; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr.144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; **Vendimet e Gjykatës Kushtetuese**: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr.58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016. dhe ligjin nr. **44, datë 18.07.2019** (FIZ nr.131/2019).

Në Kodin Penal të RSh parashihet si vepra penale që dënohet me gjobë ose burgim rastet:

- Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat material nuk janë të lehta (*neni 150*).
- Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me zjarr (*neni 151*).
- Shpërdorimi i tokës në kundërshtim me destinacionin e saj. Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dhe Pushtimi i tokës (*neni 200*).
- Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik (*neni 203*).
- Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara apo/dhe Peshkimi i kryer

me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, (204).

- Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara (*neni 205*).
- Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr; dhe kur kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës; si dhe kur kjo vepër, ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkaktonte dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet (*neni 206/a*).
- Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr; dhe kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkaktonte dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, (*neni 206/b*).

Shtesa dhe Ndryshime thelbësore reflektohen në ligjin nr. 44, datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, përfshijnë veprat penale që denohet me gjobë ose burgim në rastet:

- Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj; kur është kryer në zona të mbrojtura si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës (*neni 201*).
- Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkaktonte ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë; kur shkaktonte ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve; ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit (*neni 201/a*).
- Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente (*neni 201/b*).
- Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë implantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë; kur shkaktonte ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve; ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit; kryhet nga pakujdesia (*neni 201/c*).
- Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi,

eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë **dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë** (neni 201/ç).

Për herë të parë në Kodin Penal përcaktohet se:

- Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve (neni 202).
- **Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre**, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve (neni 202/a).
- Veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore (neni 202/b).



KAPITULLI

II



RRETH MBIKËQYRJES
(WATCH-DOGGING)

KAPITULLI II - RRETH MBIKËQYRJES (WATCH-DOGGING)

Mbikëqyrja/Vëzhgimi përdoret për të përshkruar aktivitetet e OShC-ve, rrjetit të OJF-ve lokale dhe të atyre që do të vëzhgonin njerëzit, organizatat apo/dhe stafin dhe drejtuesit e qeverisjes vendore në pozicionet e influencimit të pushtetit, për të siguruar që ata të mos abuzojnë me pozitat e tyre të privilegjit në kurriz të publikut (ose mirëqenien e komunitetit të caktuar).

Mbikëqyrja/Vëzhgimi ndihmon në dhënien njerëzve dhe OJF-ve të mjeteve të duhura për të vëzhguar, monitoruar, zbuluar, analizuar, vlerësuar dhe raportuar në mënyrën e duhur veprimtaritë dhe sjelljet e padëshiruara të qeverisjes vendore; një mjet i dobishëm për vëzhguesit që ndërtojnë njohuri dhe edukojnë të tjerët mbi sukseset dhe sfidat.

Mbikëqyrja/Vëzhgimi bëhet e rëndësishme në kontekstin shoqëror kryesisht në rastet kur ka një mungesë të dukshme vullneti nga qeveria për të zbatuar një grup ligjesh apo legjislacionin ekzistues në çdo nivel apo në rastet e mos zbatimit të standardeve të veprimtarisë nga një subjekt i caktuar, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komuniteteve dhe në mjedisin natyror.

Mbikëqyrja publike është ndër të tjera dhënia njerëzve të mjeteve të duhura për të raportuar në mënyrën e duhur nëse një shërbim i monitoruar është i dobishëm apo abuziv, nga aktivitetet e një individi, biznesi, grup jofitimprurës dhe organeve qeveritare, në emër të publikut dhe për të siguruar që ata të mos sillen në mënyrë të paligjshme ose joetike.

Mbikëqyrja është veçanërisht e zakonshme ku qeveritë janë, në parim, demokratike dhe transparente. Për t'i mbajtur ata përgjegjës ndaj një grupi të lartë standardesh për qeverisjen, transparencën dhe efikasitetin, ku organizatat mbikëqyrin sektorin publik, sektorin e biznesit dhe mjedisin.

Nga mbikëqyrja përfiton publiku. Një kulturë e mbikëqyrjes kultivon një mjedis ku individët marrin përgjegjësinë për shërbimin publik. Mbikëqyrësit më të mirë e bëjnë këtë në mënyra që zgjerojnë konsensusin dhe inkurajojnë standarde të larta; ka të bëjë me balancimin e të kuptuarit se çfarë është mbikëqyrja dhe realitetit (duke parë shembuj të një vëzhgimi të tillë dhe rezultatet). Bëhet fjalë për mbajtjen përgjegjëse të institucioneve apo njerëzve dhe kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme në varësi të asaj që synon të arrijë mbikëqyrësi.

Gjithashtu, procesi i identifikimit dhe analizimit të problemeve kryesore dhe të ndikimeve negative në menaxhimin e mjedisit natyror dhe të burimeve natyrore do të këshillohet edhe me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), Planin e Detyruar Vendor (PDV), Planin e Veprimit në Mjedis (PVM) të bashkisë si dhe me planet apo projektet për administrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore (PMBN) dhe zonat e mbrojtura mjedisore (PIMZM).

Burimet që do të përdoren për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave duhet të jenë të pa kufizuar, të integruar dhe një kombinim ndërmjet:

(i) Analizës ligjore-institucionale dhe shqyrtim të dokumentacionit, si metodë cilësore e cila përfshin një analizë të të gjitha akteve ligjore në fuqi, vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në lidhje me administrimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore; kuadrin ligjor që rregullon fushën e veprimit të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal; të aktet administrative që përcaktojnë rregulla të përgjithshme, norma e standarde të detyrueshme në kushtet e qeverisjes vendore.

(ii) Pyetësi dhe anketimet konsistojnë në grumbullimin dhe interpretimin e gjetjeve që përfshin llojshmërinë e intervistave me grupet e interesit në sektorë të ndryshëm, me punonjësit e administratës, kryepleqtë, mësues, të rinj, shoqata biznesi, individë, etj., Po kështu analizën statistikore si dhe çështje të veçanta apo për aktivitetet e ekspozuara ndaj korrupsionit. Njëherazi me identifikimin e risqeve kryhet edhe identifikimi i faktorëve të riskut (burimet, ndikimin, shkaktarët).

Aktivitetet e parashikuara për t'u realizuar, sipas kësaj metodologjie, përfshijnë:

- Krijimi i Grupit të punës të përbërë nga drejtuesit e OJF-ve lokale (pjesë e rrjetit) ku përfshihet dhe eksperti i jashtëm (i pavarur), i cili nuk duhet të jetë punonjës të administratës publike vendore.
- Grupi i punës drejtohet nga Kryetari i organizatës partnere.
- Plani i punës së grupit, duhet të bazohet në zbatimin e dokumentin metodologjisë, miratohet dhe ndiqet nga drejtuesi përgjegjës i organizatës dhe eksperti.
- Vlerësimi dhe analizimi i të dhënave të anketimeve, sipas njësive administrative dhe në nivel bashkie.
- Raporti dhe rekomandimet.

2.1. ÇFARË ËSHTË NJË WATCH-DOG (QEN ROJE)?

Përkufizohet, në përgjithësi, si një person ose grup personash që vepron si mbrojtës, kujdestar ose vëzhgues kundër joefikasitet, praktikave të paligjshme ose praktikave të tjera të padëshirueshme dhe kërkon të mbrojë të drejtat e njerëzve/komunitetit.

Në praktikën ndërkombëtare (kryesisht në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë) konsiderohet si një evoluim i termit "**qen roje**" (watchdog), i cili, sipas fjalorit të gjuhës angleze, përkufizohet si "një qen që mbahet për të ruajtur pronën".

Një "qen roje", po ashtu, siguron një kontroll ose ekuilibër brenda sistemit, duke punuar për të rritur efektivitetin dhe integritetin. Vëzhguesit hetojnë, zbulojnë, kontrollojnë, ekspozojnë, pyesin, marrin në pyetje dhe nuk besojnë derisa të zbulohet prova e së vërtetës.

Kësisoj, qëllimi kryesor i një "qen roje" është të mbështesë dhe përmirësojë efektivitetin e sistemit të monitoruar, në vend që ta kundërshtojë ose ta kontrollojë atë. Përpos kësaj ata mbikëqyrin qeverinë, biznesin, mjedisin dhe çdo fushë tjetër ku interesi publik është i kërcënuar.

Një vëzhgues efektiv duhet të karakterizohet si më poshtë:

- **I pavarur**, veprojnë në mënyrë bashkëpunuese, por në distancë nga të gjitha palët e interesuara;
- **Neutral**, ruajnë objektivitetin dhe saktësinë në gjithçka që bëjnë;
- **I dobishëm**, ndajnë praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra me të tjerët dhe partnerët brenda vendit;
- **I ditur**, të mësojnë për politikën dhe procedurat që duhet të ndjekin praktikën më të mirë në hetimet e tyre;

- **I përgjegjshëm**, t'u përmbahen nevojave të njerëzve që i sjellin çështjet në vëmendjen e tyre;
- **Pjesë e zgjidhjes**, identifikojnë çështjet sistematike dhe bëjnë rekomandime të balancuara, të dobishme dhe të arritshme për të forcuar efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e programeve dhe operacioneve të monitoruara në vendin e tyre;
- **Konfidenciale**, të mbrojnë identitetin e ankuesve dhe të mbajë në konfidencialitet materialet e ndjeshme;
- **Të vetëdijshëm për problemet e vendit**, mbikëqyrni se çfarë mund të pengojë ose të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për vëzhgimin.

Vëzhguesit duhet ta paraqesin veten si profesionistë të respektuar dhe jo thjesht si aktivistë i një OJF-ve. Ata duhet të dinë të zgjedhin betejat e tyre dhe të gjejnë qasjen e duhur sipas rrethanave dhe audiencës së synuar. Përpyekjet e tyre duhet të lidhen me synimet dhe duhet të shihen si të paanshme.

Me pak fjalë, OJF dhe rrjetëzimi i tyre mund të jenë një mbikëqyrës në nivel lokal dhe kombëtar, që mund të monitorojnë thuajse çdo problem dhe që mund të drejtoni vëmendjen apo aksionin thuajse te çdo grup përfitues të burimeve natyrore, bizneset, ose institucionet që kanë ndikim në mirëqenien sociale-ekonomike dhe politike të komunitetit.

Ka padyshim një sërë arsyesh pse organizata dhe rrjetëzimi mund të veprojnë si mbikëqyrës. Shumica prej tyre kanë të bëjnë me kryerjen e veprimit dhe kauzës së duhur dhe t'i shërbejnë komunitetit, në kuadër të misionit dhe strategjisë të OShC.

Ashtu si me shumicën e aktiviteteve të lidhura me politikën, funksionimi si mbikëqyrës është diçka që duhet bërë vazhdimisht nga thuajse të gjithë. Po ashtu siç ka njerëz dhe grupe që mund të jenë më efektive si mbikëqyrës/vëzhgues se të tjerët, ka raste kur aktiviteti i mbikëqyrësve është veçanërisht i përshtatshëm dhe i dobishëm.

Këto veprime mund të ndërmerren në rastet:

- **Kur po kërkoni të krijoni ose ndryshoni ligje ose rregullore.** Aktiviteti Watch-dog është i dobishëm për të forcuar argumentet për ndryshimin që jeni duke mbrojtur. Këto mund të përfshijnë ligjet mjedisore, rregullat ose çfarëdo aktet nënligjore në drejtim të ruajtjes së natyrës dhe të burimeve natyrore, apo dhe të ndërlidhura me ligje të tjera.
- **Kur një projekt i ri po fillon ose do të fillojë**, dhe keni dyshime për ndikimin e tij, pasi nuk janë respektuar kuadri ligjor, e drejta mjedisore për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe do të ketë një ndikim mjedisor më shumë përtej asaj që është parashikuar, duhet që vëzhgimi juaj të tregojë se keni të drejtë, mund të argumentoni apo të shmangni ose ndryshoni projektin për të mënjeluar pasojat negative.
- **Kur beson se interesi publik është i kërcënuar** dhe se ligjet ose rregulloret veprojnë për të përfituar një individ ose grup të vogël në kurriz të pjesës tjetër të komunitetit; kur njësi ekonomike dhe qeverisja vendore është duke u angazhuar në praktika që kërcënojnë shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike, mjedisin veçanërisht në drejtim të komunitetit; duhet të argumentoni dhe të reagoni për të mbrojtur interesat më të mira të komunitetit.
- **Kur një njësi ekonomike ose individ, qeveri ose një zyrtar qeveritar, një biznes**

ose industri, një program shërbimi njerëzor, etj., ka rezultuar i pabesueshëm në komunitet.

- **Kur merrni informacion për veprime ose praktika aktuale, të planifikuara ose të mundshme të dëmshme ose të dyshimta.** Në raste të tilla, nga një sinjalizues i besuar ose nga hetimet tuaja, vërehet se ka ndodhur një sjellje ligjore, se procedurat e përcaktuara nuk po ndiqen, një formë e padrejtësisë ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodh, pa pjesëmarrjen e komunitetit dhe të palëve të interesuara, kjo situatë duhet të denoncohet dhe hidhet dritë mbi praktikën e errëta, mbi transparencën dhe të parandalojnë korrupsionin dhe abuzimin me publikun. Për këtë mblidhni fakte rreth gjendjes aktuale të çështjes dhe/ose në lidhje me politikën dhe praktikën aktuale të subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.

2.2. GAZETARIA INVESTIGATIVE DHE ROLI MBIKËQYRËS I SAJ

Gazetaria mbikëqyrëse është një formë e gazetarisë gjurmuese, ku gazetarët apo botuesit e një publikimi lajmesh, kontrollojnë faktet dhe intervistojnë figura politike dhe publike për të rritur përgjegjshmërinë. Gazetaria mbikëqyrëse zakonisht merr një formë të raportimit rreth aspekteve dhe çështjeve të posaçme, të paqarta.

Janë konsideruar tradicionalisht si instrumente për funksionimin e shëndetshëm të demokracisë, pasi gazetaria dhe procesi demokratik janë shumë të ndërlidhura. Duke përmbushur rolin e vëzhguesit/kujdestarit, gazetarët veprojnë si pozita e katërt, duke zbuluar keqbërjet dhe duke shqyrtuar dhe analizuar punën dhe veprimet e autoriteteve qendrore dhe lokale të çfarëdolloj për të hetuar, raportuar dhe nxjerrjen në pah të të metave dhe mosrealizimit si dhe përgjegjësitë përkatëse.

Gjatë punës së tyre, gazetarët mbikëqyrës mbledhin informacion rreth keqbërjeve të njerëzve në pushtet dhe ia dorëzojnë publiku në mënyrë që publiku të mund të kuptojë se çfarë ndodh në shoqëri dhe të ndalojë keqbërjet. Për të bërë punën e tyre, mbajtja e një distance të caktuar nga njerëzit në pushtet është e nevojshme për të sfiduar veprimet e tyre.

Roli i shtypit për të qenë një "mbikëqyrës" dhe për të mbikëqyruar veprimet e një qeverie ka qenë një nga elementët thelbësorë të një shoqërie demokratike.

Gazetarët e përfshirë në këtë fushë të veçantë të raportimit të lajmeve potretizohen si eksplorues ose gjuetarë të çështjeve të rëndësishme të lajmeve, përvoja e të cilëve lind ndjenjat e besimit të padiskutueshëm. Puna si gazetar investigativ zakonisht identifikohet me një mentalitet më ndërhyrës, kritik ose skeptik, krahasuar me mentalitetin ose këndvështrimin e adoptuar nga profesionistët që punojnë në raportime rutinë.

Gazetaria investigative u sjell dobi demokracive, duke i njoftuar qytetarët për keqbërje, korrupsion dhe duke i mbajtur aktorët politikë përgjegjës për veprimet e tyre.

Hulumtimi i fokusuar në funksionin mbikëqyrës të gazetarisë ka zbuluar mbështetje të gjerë nga audienca, lidhur me konceptin e organizatave mediatike si vëzhguese të pushtetarëve në një sfond të vlerësimeve kundërshtuese apo të mospërputhjeve në lidhje me masën në të cilën gazetarët janë aktualisht, duke kryer rolin e tyre si roje/mbikëqyrës.

2.3. ÇFARË ËSHTË TRANSPARENCA?

Transparenca: nënkupton transparencë, komunikim dhe llogaridhënie. Gjithashtu, nënkupton që ndarja e informacionit të plotë, të saktë, në kohë dhe të dobishme rrit njohuritë, ul rrezikun dhe rrit vendimmarrjen, zgjedhjen ose veprimin nga përdoruesit

e informacionit dhe zbuluesit, veçanërisht për çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien publike.

Transparenca: është besim i ndërsjellë, ndërtohet aty ku pala përgjegjëse ofron informacionin e duhur për publikut, duke lejuar akses të lehtë në informacionin e saktë kur është e nevojshme.

Karakteristikat kryesore të transparencës:

- Qartësia se si formohen strukturat në nivele të ndryshme lokale.
- Qartësia në vendim dhe në proceset e zhvilluara.
- Objektiva të qarta që e bëjnë të lehtë monitorimin, vlerësimin, gjurmimin, performancën dhe rezultatet programore.
- Ndarje informacioni, duke përfshirë të dhënat.
- Hapja ndaj ideve dhe reagimeve, veçanërisht nga nivelet lokale.

Transparenca mund të kategorizohet gjerësisht në tre mënyra: **E errët; E qartë dhe E synuar.**

Transparenca e errët, i referohet shpërndarjes së kufizuar të informacionit, zakonisht duke mos zbuluar specifikat, p.sh, se si institucionet në të vërtetë sillen në praktikë, si marrin vendime ose rezultatet e sakta të veprimeve të tyre. Një transparenca e tillë zakonisht ofron informacion të përmbledhur dhe të paplotë dhe mund të rezultojnë të pabesueshme.

Transparenca e qartë, i referohet shkëmbimit të informacionit të qartë, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm mbi politikat dhe programet ose performancën, përgjegjësitë dhe shpenzimet institucionale. Një transparenca e tillë mund të quhet edhe si e plotë ose transparenca e gjerë.

Transparenca e synuar, përkufizohet si politika të ligjëruara nga qeveria për të përmirësuar veprimtarinë dhe cilësinë e shërbimit publik, për të reduktuar rreziqet, sigurinë dhe stabilitetin financiar ose për të përmirësuar performancën e institucioneve kryesore. Kjo përdoret veçanërisht kur transparenca e qartë ose e gjerë mund të ketë ndikime negative, kryesisht në situata ku nevojiten zgjedhje të caktuara nga publiku.

2.4. PESË QASJE STRATEGJIKE PËR MBIKËQYRËSIT LOKALË

2.4.1. HAPI I PARË: ÇAKTONI TEMATIKËN/ÇËSHTJEN QË DONI TË MBIKËQYRNË.

E rëndësishme është që në këtë proces të jini mjaft të qartë se përse po mbikëqyrni këtë çështje/problematike, duke marrë në konsideratë:

1. Qëllimi i përgjithshëm:

- “Çfarë doni të arrini në planin afatgjatë”?
- “Çfarë doni të kërkonin nga organet përgjegjëse shtetërore, në nivel lokal”?
- “Çfarë doni të ndryshoni dhe nga cili/ët e presin këtë ndryshim”?
- “Çfarë doni të ndryshoni në sjelljen dhe vetëpërgjegjëshmërinë e komunitetit dhe të palëve të tjera të interesit”?

2. Objektivat specifike:

Cilët janë hapat e matshëm që duhet të përmbushni për të ecur drejt qëllimit tuaj?

Përcaktimi i asaj që doni të arrini është vendimtar. Kur keni një qëllim të përcaktuar mirë, mund të mbështeteni plotësisht në të dhe ju ndihmon të udhëheqin pengesat dhe të përcaktoni edhe gjëra të tjera: Kë duhet të bindni dhe çfarë veprimi specifik duhet të ndërmerri; çfarë dëshironi të adresoni, përmes strategjisë dhe të mjeteve që duhet të përdorini.

Në përpjekjet ose fushatën që do të ndërmerri duhet të përcaktoni një ndryshim specifik në politikën që do të dëshironi të arrini. Është e domosdoshme që të përcaktoni dhe veprimin më specifik me të cilin do të përqendroheni mbi vendimmarrësit, palët e interesuara ose ndikuesit, duke u fokusuar:

Cila është çështja/et që lidhen me tërësinë e problematikave që shqetësojnë komunitetin në nivelin lokal, që lidhen me përmirësimin e menaxhimit, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit apo/dhe burimeve natyrore?

Pasi të keni përcaktuar se tek cilët prej grupeve përbërëse të komunitetit do të fokusoheni, çdo pjesëtar i grupit të OJF-ve duhet të përfshihet në procesin e reagimit ndaj çështjes/ve që shqetësojnë komunitetin.

Pas identifikimit të çështjes/ve që janë me interes për komunitetin, pjesëtarët e grupit të OJF-ve duhet të:

- Zhvillojnë biseda informale me individë që i përkasin grupit/eve të shënjestruara.
- Përdorimin e burimeve, mjetet teknike dhe profesionale të ndryshme që kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi komunitetin në tërësi.

2.4.2. HAPI I DYTË: ANALIZONI TEMATIKËN.

Analiza e tematikës është hapi më i rëndësishëm i të gjithë procesit mbikëqyrës. Në këtë çast mësoni gjithçka që nevojitet, në mënyrë që të shpjegoni apo diskutoni në tryeza të ndryshme, në lidhje me çështjen dhe situatën për të cilën jeni të interesuar.

Në fillim duhet të merrni vendimin se çfarë çështje (brenda fushëveprimit tuaj të punës) do të merreni me të dhe çfarë doni të arrini. Ju duhet të pyesni se çfarë (pikërisht) e konsideroni si problem dhe i kujt është problemi më i rëndësishëm. Gjithashtu, duhet të dini se si është gjendja aktuale, cilat janë politikat, ligjet dhe rregulloret përkatëse që e formësojnë këtë gjendje aktuale.

Në përputhje me grupin e shënjestruar dhe çështjet e identifikuar duhet të fokusoheni tek problematikat e ruajtjes, promovimit dhe adresimit të një menaxhimi të qëndrueshëm të mjedisit, vlerave dhe burimeve natyrore, apo për ZMM, të lidhura me organet përgjegjëse shtetërore, por edhe me organet e pushtetit vendor, që kanë detyrime për të përmbushur të gjitha nevojat apo pritshmëritë e komunitetit për burime natyrore.

Andaj është e domosdoshme që të identifikoni se “kush” është përgjegjës dhe për “çfarë” në nivelin lokal, në lidhje me politikat, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, brenda territorit të bashkisë.

Rrugët mund të jenë nga më të ndryshmet në funksion të objektivit dhe organeve që shënjestroni (targetoni). Me qëllim që të komunikoni në mënyrë efektive, duhet identifikuar qartë publiku kryesor apo grupet e synuara, duke përfshirë figura që kanë ndikim (ato jo qeveritare) dhe mediat, të cilat kanë një interes në veprim ose janë të prekura.

Analiza e aktorëve të intersit është një element i rëndësishëm në procesin e mbikëqyrjes,

i cili mund të kryhet në çdo moment pasi të keni zhvilluar analizën e gjendjes edhe lidhjen me çështjen e advokimin.

2.4.3. HAPI I TRETË: KËRKIMI I TË DHËNAVE.

Mekanizmat e kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave janë të shumta, megjithatë organizatat apo personat që punojnë për mbikëqyrjen mjedisore, duhet të marrin në konsideratë disa teknika për kërkimin dhe hetimin e tyre.

Kërkimet mund të të ndihmojnë të arrish në synimin e planifikuar, duke:

- Mësuar gjithçka që duhet të dini për të qenë në gjendje të shpjegoni dhe diskutoni sfondin e çështjes/ve, situatë/ve dhe subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.
- Mbledhur fakte rreth gjendjes aktuale të çështjes dhe/ose në lidhje me politikat dhe praktikat aktuale të subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.
- Ndërtoni një rrjet dhe siguroni burimet.

2.4.4. HAPI I KATËRT: VENDONI SE ÇFARË DO TË BËNI ME INFORMACIONIN E GRUMBULLUAR.

Informacioni që keni grumbulluar përbën “thesarin” e çështjes së mbikëqyrjes. Nuk është e rëndësishme nëse keni gjetur pikërisht atë që kërkoni ose jo; nëse informacioni që keni siguruar devijon nga mendimi apo hamendësimi fillestar; nëse ide të reja apo një plan i ri duhet menduar sepse nuk keni mjaftueshëm informacion; nëse aktorët apo grupet e synuar nuk janë përgjigjur apo shumë prej palëve të interesit janë kundërshtarë të çështjes etj., në këtë moment duhet të vendosni se çfarë do të bëni me të dhënat që keni.

Si të shfrytëzoni informacionin në të mirë të çështjes që po mbikëqyrni?

• Duke mos bërë asgjë.

Gjatë kohës që jeni në kërkim të informacionit mbi çështjen mjedisore, situata mund të këtë filluar të ndryshojë në drejtimin e duhur dhe midis palëve të prekura ka nisur një proces negocimi. Kjo përjasje është shumë pozitive dhe një vëzhgim i mirë mjedisore duhet gjithmonë që në çdo hap të saj të synojë nxitjen e bisedimeve dhe bashkëpunimeve, pra negociatave. Në këtë rast nuk është e nevojshme të ndërmerren veprime të tjera.

• Duke bërë çështjen publike.

Mund të këtë shumë kuptime, por në këtë rast nënkupton advokimin në strukturat publike, private e media, bërjen publike të problemit si dhe nisjen e një fushate të fuqishme advokim/lobimi, në mënyrë që të sigurojmë një mbështetje publike sa më të gjerë.

Në këtë kontekst OSHC-të dhe rrjetet lokale ndihmojnë në forcimin e bashkëveprimit dhe përmirësimin e bazës së njohurive dhe në këtë mënyrë rritet edhe ndikimi i shoqërisë civile në komunitet, për një ose disa çështje me interes madhor të tyre.

Qasja e lehtësimit bashkëpunues, për zgjidhje alternative të konflikteve, mund të realizohet nëpërmjet OSHC-ve, të cilat, me mbështetje teknike dhe logjistike, e përcjellin më mirë se kushdo në publik shqetësimin dhe organizimin e reagimit, ndaj strukturave përgjegjëse. Takimet duhet të jenë korrekte, duke trajtuar një çështje konkrete që nxitë sedrën dhe angazhimin konkret të tyre.

Roli i ndërmjetës dhe lehtësues duhet të jetë neutral dhe i pavarur, pasi është një rol teknik në organizimin e procesit të identifikimit, organizmit, komunikimit, lobimit dhe reagimit ndaj dukurive negative apo proceseve që cenojnë jetesën e komuniteteve, por njëherazi edhe ekzistencën e vlerave dhe të burimeve natyrore.

2.4.5. HAPI I PESTË: VAZHDIMI I MBIKËQYRJES PËR NJË KOHË TË GJATË.

Qëndrueshmëria është procesi aktiv i vijimit të nismës së mbikëqyrjes, jo thjesht vazhdim i programit tuaj, por zhvillim i marrëdhënieve, praktikave dhe procedurave që bëhen pjesë e qëndrueshme me komunitetin. Zhvillimi i një plani/strategjie për qëndrueshmërinë e nismës së mbikëqyrjes do të rrisë ndikimin dhe mbështetjen ndaj tij, pasi dhe qëllimi, në këtë rast, është të vijoni mbikëqyrjen, arritjen e objektivave, kryerjen e aktiviteteve përfutuese afatgjatë për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe të burimeve natyrore.


Mbikëqyrja/Vëzhgimi mjedisore nuk duhet të përfundojë më arritjen e një marrëveshjeje, me fitim e një fushatë advokuese apo edhe me fitimin e një rasti në gjyqësor.

Në këtë kontekst, ndër rreziqet më të zakonshme mund të përmendim:

- Nevoja e OShC-ve për burime njerëzore për t'u angazhuar për një kohë të gjatë, sikundër kërkohet në këtë metodologji. Procesi dhe puna vëzhguese nuk përfundon asnjëherë, shpesh duhet të kaloj në një angazhim vullnetar të nismëtarëve, pas përfundimit të projektit.
- Kërcënimet, janë përherë problematik, kur ndodhin. Mbikëqyrësit duhet të jenë shumë të kujdesshëm, të besueshëm dhe të vlerësojnë shumë mirë rrezikun në nivel personal apo si organizatë përpara se t'a bëjnë çështjen publike. Po ashtu duhet të krijojnë aleancat e duhura, të konsoliduara dhe shumë të fuqishme me mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë.
- Shpenzime të paparashikueshme, në çdo hap të mbikëqyrjes edhe pse ka një linjë logjike është i paparashikueshëm në varësi të gjetjeve. Në këtë mënyrë aktivitetet e ndërmarra mund të dalin menjëherë dhe të pa planifikuara.
- Rastet e denoncuara në gjyqësor zgjaten dhe shpesh mund të mos përfundojnë pozitivisht, fatkeqësisht ka shumë të tilla në lidhje me keqpërdorimet e mjedisit dhe të burimeve natyrore, andaj këshillohet që çështja e mbikëqyrur dhe e bërë publike të zgjidhet pa e paraqitur në gjyqësor.



KAPITULLI



ZHVILLIMI I STRATEGJISË SË
ADVOKIMIT/LOBIMIT

KAPITULLI III – ZHVILLIMI I STRATEGJISË SË ADVOKIMIT/LOBIMIT

Advokim-lobimi është proces strategjik dhe i qëllimshëm për të sjellë ndryshime në politikat dhe praktikën mjedisore e natyrore. Kjo mund të ndodhë në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Një strategji advokim-lobimi, që kërkon të arrijë ndryshime gjithëpërfshirëse, duhet të përfshijë aktivitete të koordinuara në të gjitha nivelet.

Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për advokim-lobim është më tepër politik sa një çështje e zhvillimit të aftësive teknike. Kjo kërkon aftësi për advokim strategjik për të ndikuar tek vendimmarrësit, për të rritur kërkesën për vlerësim dhe shqyrtim të politikave të ruajtjes së natyrës. Advokim-lobimi duhet të synojë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi vendimmarrësit dhe palët e tjera të interesit, për të mbështetur dhe zbatuar veprime që kontribuojnë në përmbushjen e një kuadri politik gjithëpërfshirës.

Advokim-lobimi nuk duhet të synojë thjesht të ndryshojë politikat dhe praktikën, por të sfidojë dhe të ndryshojë mënyrën se si njerëzit perceptojnë aftësinë e tyre për t'u integruar në proceset vendimmarrëse.

Në këtë kontekst disa OShC po i adresojnë çështjet e ruajtjes së natyrës dhe të burimeve natyrore përmes projekteve dhe programeve, të cilat janë bërë pjesë e punës së tyre, duke përfshirë advokimin në të gjitha planet e tyre strategjike. Në thelb, përdorimi strategjik i advokimit është për të ndikuar në politikat e fushës së ruajtjes së natyrës dhe një përpjekje për të përmirësuar cilësinë e jetës së komuniteteve.

Shpesh politikat lokale e kombëtare, për të mbrojtur natyrën dhe burimet e saja, mungojnë, janë joefektive ose nuk zbatohen. Në këtë kuadër advokim-lobimi është procesi i qëllimshëm i ndikimit të atyre, të cilët marrin vendime për zhvillimin, ndryshimin dhe zbatimin e politikave.

- Advokim-lobimi i OShC-ve, në rastin tonë, fokusohet në çështjen e mirëqeverisjes së ZMM-ve dhe të përdorimit të ballancuar të burimeve natyrore.
- Pjesë e rolit të OShC-ve është të lehtësojë ose të krijojë ura mes njerëzve që jetojnë, brenda dhe në afërsi të ZMM-ve dhe institucioneve lokale, qeverisë qendrore, parlamentit, etj., roli i të qenit një mbledhës është, në fakt, një qendër për promovimin e dialogut që rezulton në përmirësimin e politikave dhe të legjislacionit pro natyrës.
- Për OShC-të, advokim-lobimi është mjeti me të cilin duhet të ndikojnë vendimmarrësit ose taktikat, ndërsa politika është përmbajtja, atë që duam të ndryshojmë.

Përdorimi i doracakut do të ndihmojë si të përcaktoni mjete të veçanta që iu interesojnë më së shumti, në varësi të nevojave individuale dhe në cilën fazë jeni aktualisht për planifikimin e strategjisë të advokim-lobimit. Gjatë këtij procesi, njëherazi, mund të dëshironi të shqyrtoni se si mund të interpretohen hapat në lidhje me rrethanat specifike, në varësi të faktit nëse fokusoheni në nivel kombëtar apo lokal, për të cilin janë bërë rekomandime apo këshillat për strategjinë në këtë doracak. Ky doracak ofron një sërë hapash shtesë që mund të ndërmerren për të mbrojtur në mënyrë efektive politikat dhe sistemet kombëtare e lokale të vlerësimit të fushës së natyrës, të cilat orientohen drejt standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.

3.1. Çfarë është advokacia

Advokimi është një strategji për të ndikuar në politikë-bërësit (p.sh. njerëzit me pushtet formal politik si anëtarë të parlamentit, zyrtarë qeveritarë, politikanë apo nëpunës publikë) për të bërë një ndryshim të politikave publike - përgatitjen dhe miratimin e ligjit, strategjisë, planit ose rendit të ditës; program ose kurs veprimi; shpërndarjen e burimeve apo ndryshimin institucional. Përpjekjet e advokatisë mund të realizohen përmes një sërë hapash të caktuar, duke përdorur strategji ose qasje të ndryshme.

Ky përkufizim shpreh një ide të rëndësishme, pasi advokimi nuk ka të bëjë vetëm me ndikimin e politikës, por, gjithashtu, dhe para së gjithash, me ndikimin tek opinioni publik. Pra, advokimi është një proces i ndryshimit social që ndikon në qëndrimet, marrëdhëniet shoqërore dhe të pushtetit, i cili forcon shoqërinë civile dhe hap hapësirat demokratike. Për të përmbushur aspiratat e tij, advokimi kërkon koordinim të përpjekjeve, mendim strategjik, informacion, komunikim dhe mobilizim. Advokimi është një proces ose një veprim për të siguruar respektimin dhe efektivitetin e të drejtave të komuniteteve apo dhe individëve. Çdokush mund të fillojë një veprim advokacie, por sa më shumë të jetë i strukturuar dhe i organizuar, aq më i lartë është shansi i suksesit. Advokimi:

- është një strategji për të ndikuar në ndryshimin e politikave ose veprimeve;
- realizohet me audiencën primare të vendimmarrësve;
- përmban një proces të qëllimshëm të komunikimit bindës, që kërkon ndërtimin e mbështetjes prapa politikës së propozuar;
- kryhet nga grupe të qytetarëve të organizuar.

Advokimi, në të gjitha format e tij, kërkon të sigurojë që komuniteti, veçanërisht ata që janë më të prekshëm, të jenë në gjendje që:

- Të shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre.
- T'u dëgjohet zëri për çështje që janë të rëndësishme për ta.
- T'u mbrohet dhe të mbrojnë të drejtat e tyre.
- Të kenë qasjen e informacioneve dhe shërbimeve.
- T'u merren parasysh pikëpamjet dhe dëshirat e tyre në vendimmarrjet që lidhen me jetesën e tyre.
- Të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Të gjejnë zgjedhjet dhe opsionet më të përshtatshme për arritjen e qëllimeve.

Në rastin e projektit "Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri", advokimi synon, drejtpërdrejtë dhe tërthorazi, të përfshijë vendimmarrësit dhe palët e tjera të interesit për të mbështetur e zbatuar veprime që kontribuojnë në përmbushjen e një kuadri politik gjithëpërfshirës si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të fushës së ruajtjes të natyrës.

3.2. Hapat e veprimit për advokim

Natyrë në Shqipëri është shumë e fragmentuar dhe e paafte për të reaguar në mënyrë efektive ndaj presioneve të reja dhe kërcënimeve të vazhdueshme, duke përfshirë prerjet ilegale, peshkimin, gjuetinë, turizmin e pakontrolluar dhe aktivitetet rekreative, ndotjen, mostrajtimin e ujërave të zeza e të përdorura, erozionin bregdetar, zjarret, ndikimet e ndryshimeve klimatike, zbatimin e dobët të ligjit dhe qasjet e paefektshme të menaxhimit

në praktikë. Natyra shqiptare po vuan këto dukuri, në shumë raste të pakthyeshme, që kanë ndikuar seriozisht në habitatet e specieve të rrezikuara dhe të rrezikuara në mënyrë kritike.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore ende nuk është integruar, siç duhet, në politikat kombëtare dhe lokale. Përfshirja e komuniteteve lokale në menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të burimeve lokale të natyrës është e pamjaftueshme. Kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikës së mjedisit dhe ruajtjes së natyrës dhe lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime të panevojshme, pasi një pjesë e madhe e popullsisë jeton në rajone rurale e të largëta.

Në thelb, advokimi është **“ushtrimi i presionit nga ana e qytetarëve përballë pushtetit të qeverisjes”**. Advokimi është një mjet për pjesëmarrjen reale të qytetarëve në vendimmarrjet nga qeveria dhe organe të tjera të fuqishme. Në të njëjtën kohë, advokimi duhet të shkojë përtej angazhimit të “qytetarëve” për të angazhuar qytetarët dhe jo-qytetarët. Në këtë rast advokimi duhet të konsiderohet si: **Akti i dhënies së mbështetjes për një politikë dhe bindjen e atyre që kanë fuqi për të vepruar në mbështetje të politikës, në nivel lokal dhe kombëtar.**

Kur flasim për advokimin, pyetja më e shpeshtë nga OSHC-të ka të bëjë me përgatitjen dhe zbatimin e një procesi ose veprimi të suksesshëm advokimi. Është e dobishme të dimë, çfarë hapash do të ndërmarim dhe çfarë duhet bërë për të arritur një ndryshim. Për të zhvilluar strategjinë tuaj të advokacisë ose për të përgatitur një fushatë, ju duhet t'u përgjigjeni pyetjeve duke përfshirë:

Çështja	Cilat çështje doni të ndryshoni politikën publike? Cila është situata aktuale në këtë fushë?
Qëllimi dhe objektivat	Çfarë doni të arrini? Cili është qëllimi juaj i advokimit, cilat janë objektivat që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit tuaj të përgjithshëm?
Grupet e synuara	Cilët janë objektivat (krijuesit e politikave, vendimmarrësit, etj.) Që ju duhet të adresoni për të arritur qëllimin tuaj?
Tipet e advokacisë	Cila është qasja juaj ndaj advokimit (p.sh., drejtpërdrejt ose indirekt)?
Aktivitetet	Cilat janë aktivitetet specifike që do të kryeni? Cila do të jetë afati dhe shkalla e ndikimit?
Mesazhi	Cili është mesazhi juaj i advokimit që dëshironi t'i dërgoni grupit tuaj të synuar?

Në fillim ju duhet të merrni vendimin se çfarë çështje (brenda fushëveprimit tuaj të punës) do të merreni me të dhe çfarë doni të arrini. Është koha kur po shikoni përreth, duke bërë kërkime për aspekte të ndryshme të situatës. Ju duhet të pyesni se çfarë pikërisht ju e konsideroni si problem dhe për kë është problemi i rëndësishëm. Ju gjithashtu duhet të gjeni se çfarë është gjendja aktuale, dhe cilat janë politikat, ligjet dhe rregulloret përkatëse që e formësojnë gjendjen aktuale.

Hapat kryesorë të strategjisë së advokimit janë:

• **Zhvillimi i strategjisë së advokimit**

Kjo pjesë e advokimit përqendrohet në përgatitjen e qartë të qëllimeve dhe objektivave, identifikimin e audiencës së synuar dhe zgjedhjen e qasjes adekuate të advokimit.

• **Përcaktimi i qëllimeve**

Përcaktimi i asaj që duam të arrijmë është vendimtar. Kur kemi një qëllim të përcaktuar mirë, ne mund të mbështetemi plotësisht në të dhe na ndihmon të udhëheqim përmes pengesave dhe të përcaktojmë edhe gjëra të tjera: kë dëshirojmë të adresojmë, cilat strategji dhe mjete duhet të përdorim. Qëllimi në përpjekjet ose fushatën tonë duhet të përcaktojë një ndryshim specifik në një politikë që do të dëshironim të arrijmë. Është e domosdoshme të shkruash një qëllim me një folje aktive që përcakton dhe veprimin dhe specifikimin e zonës me të cilën përqendrohemi.

• **Planifikimi i fushatës**

Kur të keni një strategji, duhet ta përktheni atë në planin e advokimit që nuk është gjë tjetër veç një grup aktivitete të qarta dhe të strukturuar brenda një afati kohor të caktuar. Është e nevojshme të vendosni, se si do ta transformoni strategjinë tuaj në aktivitete, sa logjikisht do të jenë fazat e fushatës suaj ose aktivitetet tuaja të lidhura dhe mbështetur me njëra-tjetrën dhe cila do të jetë koha dhe niveli i fushatës. Plani duhet të përmbajë edhe linjën e medias me mesazhin kryesor që dëshironi të merrni dhe vendimet mbi strategjitë e advokimit që do të përdorni - presionin e publikut dhe mediave, negociatat, lobimin, etj. Për të qenë në gjendje të realizoni veprimet duhet të kërkonit burime (financiare, materiale, lehtësira, etj.) dhe zhvilloni një buxhet, por është mirë të dihet se nëse nuk keni burime, ju mund të përdorni fonde nëpërmjet njerëzve që kanë interes për çështjen.

• **Puna me njerëzit**

Kur flasim për njerëzit në advokim mund të shikojmë nga këndvështrime të ndryshme mbi "kush është kush". Bashkëpunëtorët janë njerëz që ndikojnë në problemin dhe zgjidhjen e tij, ose janë të ndikuar nga problemi.

Në fillim të punës suaj është e rëndësishme të hartojmë dhe analizojmë palët e interesuara dhe të shohim se cilët janë njerëzit e interesuar për kauzën tuaj, sa kundërshtarë apo përkrahës të mundshëm keni. Analizimi i palëve të interesuara dhe kuptimi i motivimit dhe interesave të tyre iu jep bazën për përgatitjen e hapave të veçanta të veprimit. Nëse nuk e krijoni me kujdes hartën e partnerëve, nuk do të jeni në gjendje të punoni plotësisht me potencialin njerëzor përreth jush.

• **Trajtimi i aleatëve**

Puna për trajtimin dhe vlerësimin e aleatëve, duhet të përqendrohet në:

- Bindjen e aleatit që pozicioni dhe puna e organizatës suaj është e drejtë dhe e nevojshme për çështjen që advokoni.
- Bindjen e aleatit se çështja, programi, objektivat dhe masat/veprimet e paracaktuara janë të rëndësishme, ato që duhen dhe të mjaftueshme për të garantuar suksesin.
- Bindjen e aleatit për nevojën dhe garancinë që sjell krijimi i aleancave për një advokim efektiv.
- Bashkëpunimi ndikon për të rritur kapacitetet e ndërsjella dhe për të rritur ndikimin mbi vendimmarrësit.

Gjërat kryesore që duhet të dini rreth aleatëve:

- Sa mirë e mbështesin çështjen e advokim-lobimit?
- Çfarë mendojnë me të vërtetë për zgjidhjet e çështjeve?
- A kanë ndonjë dyshim për fushatën e advokim-lobimit? Nëse PO, cilat janë ato?
- Çfarë shpresojnë të fitojnë nga procesi i advokim-lobimit?
- Cila është baza dhe mbështetja e tyre për fushatën?
- Çfarë mund të bëjnë ata për të mbështetur fushatën?
- Sa të përfshirë dhe të informuar presin ata, të jenë?
- A kanë çështje me ndonjë aleat tjetër të ardhshëm?

• **Trajtimi i kundërshtarëve**

Analiza dhe trajtimi i kundërshtarëve është më thelbësorja, pasi lidhet ngushtësisht me interesa të mëdha, por dhe me procesin e fushatës së advokim-lobimit. Mund të konsiderojmë si “kundërshtarë” të një veprimi advokim-lobimi, njerëzit, organizatat, institucionet dhe subjektet të cilët mund të kenë një ndikim negativ në arritjen e qëllimit. Ata nuk duhet të konsiderohen thjeshtë si përfaqësues të pikëpamjeve ndryshe, por duhen vlerësuar maksimalisht për potencialin që disponojnë dhe argumentimet e tyre që janë kundër qëndrimit tuaj.

Në të dyja rastet, duhet të jeni gati për të ndarë skenën me kundërshtarët, duhet të njihni objektivat e tyre dhe të jeni në gjendje të jepni argumente për të kundërshtuar pozicionet e tyre. Në rast se keni të dhëna të sakta, fakte dhe shifra Ju jeni në gjendje të kryeni mirë një debat publik ose të hidhni poshtë pretendimet/komentet e tyre. Kjo mund të bëjë dallimin midis një veprimi të fuqishëm dhe efektiv të advokim-lobimit me një iniciativë të dobët.

• **Zhvillimi i mesazhit të strategjisë së advokimit**

Një mesazh gjithëpërfshirës duhet përshkruar në strategjinë e advokim-lobimit. Nëse mesazhet janë të shumta, të paqarta ose shumë komplekse ata nuk mund të tërheqin vëmendjen e audiencës së synuar ose do të kenë ndikim të papërfillshëm.

Nëse qëllimi është i qartë, objektivat specifike janë përcaktuar drejtë dhe Ju e dini se çfarë ndryshimi kërkoni të bëni, thelbësore është të identifikoni se kush mund ta bëjë ndryshimin. Po kështu, është e dobishme të kujtoni rëndësinë e të pasurit të një pasqyre të qartë të kontekstit politik, legjislativ dhe të problematikave që doni të ndikoni, veçanërisht në lidhje me njerëzit ose institucionet që kanë fuqinë për të filluar ndryshimin. Ky mund të jetë një mjet i dobishëm për të siguruar palët e interesuara që luajnë një rol efektiv në përpjekjet për ndryshim dhe për procesin e vendimmarrjes. Njohja e përditësuar e situatës, njerëzve dhe e proceseve, është e nevojshme në mënyrë që të jeni të përgatitur për të advokuar e lobuar.

• **Komunikimi dhe Media**

Komunikimi me mediat është një mënyrë se si të rritet rëndësia e kauzës duke e sjellë atë në publik përmes mediave dhe duke ndërtuar një komunitet mbështetësish.

Komunikimi konsiderohet aktivitet advokues nëse grupet e synuara e përdorin atë për të ushtruar presion mbi procesin e hartimit të politikave. Nga një këndvështrim i caktuar

mund të konsiderohet si një strategji specifike advokimi, por për shkak se çdo strategji e lartpërmendur mund të ketë linjë të veçantë mediatike për të rritur ndikimin e saj, ne e paraqesim atë veç e veç.

Qëllimet e ndryshme të komunikimit ndryshojnë në aspektin e ndikimit dhe vështirësive të tyre. Nëse dëshironi të informoni, të përshkruani diçka, t'i bëni gjërat të dukshme dhe të kuptueshme, është mirë të përdorni fakte me info-grafikë. Kurrë mos harroni informimin - duke përdorur broshura, filma, karikatura, info-grafikë, etj. Kur krijohet një mesazh, mos harroni të komunikoni shkurt dhe thjesht, të jeni personal, tregoni historinë dhe reagoni në nevojat reale dhe gjendjen e njerëzve duke përdorur gjuhën e tyre dhe argumentet ku ata janë të ndjeshëm.

3.3. Lobimi, ndryshimi nga advokacia dhe mjetet për realizimin e tij

Termi "Lobim" përshkruan përpjekjet e drejtpërdrejta për të ndikuar tek politikë bërësit, zyrtarët publikë apo vendimmarrësit e tjerë, përmes takimeve personale dhe bindjes. Me lobim nënkuptohet një grup i organizuar njerëzish apo/dhe organizatash që punojnë së bashku për të ndikuar ligjvënësit ose zyrtarët e tjerë publik në vendimet e qeverisë lidhur me një çështje të veçantë, në favor të një kauze specifike.

Kur filloni punën për një iniciativë të re advokuese, gjithmonë duhet të organizoni një takim me një person ose me institucionin. E rëndësishme është që në takim duhet të prezantoheni se kush jeni, çfarë bën organizata juaj dhe pse doni të organizoni një takim me vendimmarrësin. Kur kryeni negociatën dhe paraqitni pikëpamjen duhet të jini tepër i qartë. Nëse dakortësohet takimi duhet të përgatiteni seriozisht dhe të kini një plan të hollësishëm. Ndërkohë mendoni për zgjedhjen e mjeteve të duhura për të arritur qëllimet, objektivat dhe si të mobilizoni përkrahësit dhe në të njëjtën kohë si të neutralizoni kundërshtarët.

Pra, lobimi është një strategji specifike e advokacisë për mbrojtjen e interesit publik apo privat, nëpërmjet ndryshimeve në legjislacion apo në problematika të tjera që prekin fushën e ruajtjes së natyrës. Lobimi përfshin komunikim të drejtpërdrejtë me vendimmarrësit dhe të tjerë që kanë ndikim mbi to. Lobimi ka të bëjë me edukimin dhe bindjen e tyre për të mbështetur dhe avancuar programin tuaj. Objektivat primare të lobimit janë njerëzit me fuqi për të ndikuar në një ndryshim të politikave në çështjen që kini marrë për shqyrtim.

Lobimi mund të ndodhë ose formalisht, përmes vizitave dhe informimeve të vendimmarrësve dhe të tjerëve, ose jo formalisht, nëpërmjet bisedave në kohë, vende dhe rrethana më specifike në përshtatje me çështjen e advokim-lobimit. Që procesi i lobimit të jetë i suksesshëm duhet të zhvillohet mbi një program të mirë krijuar në kontekstin e çështjes dhe të rrethanave të veçanta.

Përvoja e disa OShC-ve ka qenë e përshtatshme, pasi kanë qenë në gjendje dhe kanë krijuar marrëdhënie të qëndrueshme midis organizatave të rrjetit, duke ndikuar në njohjen dhe zbatimin e standardeve dhe të legjislacionit për ruajtjen e natyrës dhe të përdorimit të baraspeshuar të burimeve dhe vlerave natyrore. Po kështu edhe diskutimet kokë me kokë me vendimmarrësit për t'i influencuar ata për të ndryshuar politikën, praktikën ose sjelljen.

Lobimi përfshin kontaktimin e ligjvënësve dhe përpjekjet për t'i bindur ata për të mbështetur ose refuzuar një politikë. Nëse ju jeni një përbërës individual ose një grup advokimi, kur takoni përfaqësuesit me një përpjekje për të nxjerrë një ndryshim të politikave, ju jeni duke i lobuar ata.

Lobimi është një pjesë e rëndësishme e çdo grupi avokatie që kërkon të bëjë një ndryshim dhe përfshin influencimin e njerëzve në pushtet të cilët mund të ndikojnë në këto ndryshime. Ashtu si në çdo fazë të një fushate advokimi, edhe lobimi duhet të planifikohet në mënyrë strategjike për të ushtruar presionin e duhur ndaj përfaqësuesve tuaj dhe për të fituar një rezultat të favorshëm.

KAPITULLI IV




ADVOKIMI ME
MBËSHTETJEN E MEDIAVE

KAPITULLI IV – ADVOKIMI ME MBËSHTETJEN E MEDIAVE

Advokimi përmes medias është një strategji komunikimi sistematik, e cila ka për qëllim të influencojë vendimmarrësit dhe të mobilizojë komunitetin nëpërmjet kanaleve të komunikimit masiv që ata përdorin – siç janë televizionet, revistat, gazetat, radio, si dhe mediat sociale. Nëpërmjet advokimit mediatic aktivistët tërheqin vëmendjen në një problem që ka nevojë të zgjidhet, ndaj një shkelje të të drejtave themelore të njeriut apo të barazisë gjinore. Nëpërmjet advokimit gjithashtu mund të denoncohen abuzimet me pushtetin dhe korrupsioni – që mund të fillojnë nga një zyrtar i thjeshtë e të shkojnë lartë deri në korridoret e qeverisë. Nëpërmjet advokimit në media, aktivistët promovojnë një pikëvështrim të caktuar mbi një çështje që ata kërkojnë që të adresohet ose të ndreqet, ose të përqendrojnë vëmendjen e publikut dhe të vendimmarrësve mbi një zgjidhje që ata ofrojnë për një problem tashmë të njohur. Advokuesit janë një lloj relativisht i ri faktori në botën e komunikimit masiv. Advokuesi ka për detyrë të nxisë median të raportojë për lajme që ai i konsideron si të rëndësishme, por vetë media nuk i mbulon duke i gjykuar si jo të rëndësishme apo jo interesante.

Përkufizimi i advokimit mediatic është:

“Përdorimi strategjik i medias masive në mbështetje të përpjekjeve të organizuesve të bashkësive për të nxitur politika shoqërore apo publike”.




Qëllimi i advokimit mediatic është që politikëbërësit të vihen nën presion përmes mobilizimit të grupeve shoqërore dhe përmirësimit të mbulimit me lajme të çështjeve të caktuara. Kjo nuk është një përpjekje për të ndryshuar rrënjësisht median masive por më së shumti për të përdorur median për përçimin e mesazhit te politikëbërësit.

Advokimi mediatic duhet të dallojë disa hapa në procesin drejt ndryshimit të një gjendjeje (hapat paraqiten në figurën ngjitur).

Advokimi në media nuk ka si qëllim promovimin e aktivistit ose të organizatës që ai/ajo i përket në media. Qëllimi i advokimit është që çështjet për të cilat aktivistët i kanë pjesë të misionit të tyre dhe për të cilat luftojnë për t'i zgjidhur, të diskutohen në media me pjesëmarrje sa më të gjerë të aktivistëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve që ato përfaqësojnë. Gjithashtu qëllimi i këtij komunikimi është që çështja të ngrihet dhe

diskutohet në organe mediatike të cilat lexohen ose shikohen nga vendimmarrësit nga të cilët pritet reagimi ose ndërhyrja për të zgjidhur problemet.



KONVENTA E AARHUSIT DHE MEDIAT

Shoqëria civile, sektori privat dhe media duhet të luajnë një rol vendimtar në zbatimin, promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Konventës së Aarhusit.

Media luan një rol qendror në edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin mjedisor të publikut, veçanërisht informimin e qytetarëve për mënyrat për të marrë akses në informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për të siguruar qasje në drejtësi për çështjet mjedisore.

GAZETARIA MJEDISORE

Gazetaria mjedisore është...

- Mbulimi i lajmeve për mjedisin, energjinë, shëndetin dhe klimën.
- Shpërndarja e informacionit dhe zbatimi i praktikave të komunikimit që kanë të bëjnë me mjedisin. Sot, është një fushë e gjerë që përfshin kërkimin dhe raportimin se si veprojnë aktorë të ndryshëm (p.sh., institucionet, shtetet, njerëzit) në lidhje me temat që lidhen me mjedisin.
- Gazetaria e aktualitetit lidhur me natyrën dhe mjedisin, me fokus në ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin e tyre për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve.

Objektivat e saj janë të...

- Gjenerimi i një debati për çështje që lidhen me mjedisin;
- Promovimi i çështjeve që lidhen me mjedisin në mesin e popullatës;
- Siguroni sinergji me tema të tjera të paraqitura në media;
- Krijimi i sinergjive ndërmjet publikut, komunikuesve, institucioneve, OShC-ve dhe çdo agjenti të përfshirë në çështjet mjedisore;
- Promovimi i miratimit dhe përmirësimit të politikave mjedisore;

Për të ilustruar rëndësinë e gazetarisë mjedisore, mund të kthehemi në vitin 2019: ndryshimet klimatike janë bërë së fundmi shqetësimi kryesor në BE për qytetarët e saj, duke tejkalar terrorizmin global (sipas Eurobarometrit, të kryer nga Parlamenti Evropian, në fund të vitit 2019) dhe për shkak të raportimeve të mediave për ndryshimet klimatike.

Roli i medias në edukimin mjedor

Publiku mund të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore vetëm nëse ka njohuri të dhe informacionin e nevojshëm. Media luan një rol qendror në edukimin mjedor dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht duke informuar se si të arrihet akses në informacion, të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të kenë akses në drejtësi për çështjet mjedisore.

Problemet mjedisore përshkruhen nga shkencëtarët, por media e kanalizon informacionin dhe e shpërndan atë, duke ndihmuar publikun të kuptojë çështjet mjedisore. Sfida është të përçohen koncepte komplekse mjedisore dhe të jepet një ndjenjë e urgjencës së këtyre sfidave në një mënyrë që angazhon lexuesin.



Temat kryesore mjedisore sot

Çështjet mjedisore përkufizohen si probleme me sistemet e planetit që janë zhvilluar si rezultat i ndërhyrjes njerëzore ose keqtrajtimit të planetit.

- Ndotja – ajri, uji, toka, zhurma, radioaktive, drita dhe termike – të gjitha ndikojnë në mjedisin tonë;
- Degradimi i tokës - erozioni, mbikullotja, ekspozimi i tepërt ndaj ndotësve, mbjellja me monokulturë, ngjeshja e tokës, shndërrimi i përdorimit të tokës, etj.
- Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike që shkaktojnë zjarre, përmbytje, thatësi, etj.
- Përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore (mbipeshkimi, shpyllëzimi); dhe
- Humbja e biodiversitetit (rënia e pjalmuesve, shkatërrimi i koraleve).

Gazetaria mjedisore në rajon: shënime të praktikave të mira

Gazetaria mjedisore në Ballkanin Perëndimor po përballet me sfida të shumta. Në vazhdim, ne rendisim një sërë sugjerimesh dhe idesh që mund t'u shërbejnë gazetarëve, redaktorëve dhe palëve të tjera të interesit për të bërë hapa të vegjël, por zakonisht vendimtarë, përpara.

- Zhvillimi i një trajnimi gjithëpërfshirës që do të ndërtonte njohuritë e gazetarëve dhe do të ndihmonte në formimin e reporterëve të përkushtuar ndaj çështjeve mjedisore;
- Sigurimi i transparencës dhe disponueshmërisë së informacionit për gazetarët;
- Prioritizimi i temave mjedisore ndaj lajmeve të tjera, nga redaktorët;
- Promovimi i artikujve të autorizuar dhe etika e raportimit;
- Sensibilizimi i publikut mbi vlerat dhe bukurinë e natyrës dhe rëndësinë e burimeve natyrore, nëpërmjet publikimit të reportazheve, dokumentarëve, etj.;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe kultivimi i idesë se burimet natyrore mund të sigurojnë të ardhura duke u ruajtur (përdorim i qëndrueshëm);
- Këmbëngulja e gazetarëve për të bindur redaktorët e tyre se çështjet mjedisore janë të rëndësishme dhe meritojnë më shumë vëmendje mediatike;
- Numri i shtuar dhe profili i larmishëm i ekspertëve dhe palëve të interesuara që marrin pjesë në krijimin e raportit;
- Rritja e tregimit vizual që tregon degradimin e mjedisit dhe shfaqjen e gjendjes fizike të habitateve;
- Qasje kreative ndaj shkrimit të tregimeve, gjetja e një këndi dhe titujsh përkatës që do të rriste mbulimin dhe do të tërhiqte vëmendjen e publikut;
- Shmangia e qasjes populiste për të shkruar dhe vlerësuar interesat e grupit në raport me interesin e përgjithshëm;
- Gazetaria mjedisore kombinon kaq shumë tema – shkenca, politikë, krim, zgjedhje të stilit të jetesës, etj. Ajo mund të trajtohet nga shumë anë të ndryshme;
- Nëse zyrtarët dhe autoritetet nuk po ndajnë informacionin e kërkuar, eksploron burime të tjera relevante dhe gjeni mënyra për ta verifikuar atë informacion.

Burimet e lajmeve mjedisore

Environmental Health News	NPR /podcast Living on Earth
EJToday	The Environment Report
The BBC	Deutsche Welle's Living Planet
Reuters	Scientific American
Associated Press	Nature News The Weather Channel
The Guardian	EurekaAlert! NASA Climate News
The Washington Post	Earthjustice
	Earth Island Journal
The Hill	Environmental & Energy Study Institute
E&E News	EDF Voices: People on the Planet
Politico	Union of Concerned Scientists

Burimet rajonale

Organizata mediatike qw ndjekin dhe raportojnë mbi biodiversitetin, natyrën dhe në përgjithësi mbrojtjen e mjedisit (**Balkan Green Energy News**)

Mediat kryesore (**N1**, **Al Jazeera Balkans**, etc.)

BalkanInsight

Për të ndezur debatin....

Misioni i ri i gazetarisë është t'u japë zë qytetarëve që ata të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në bisedat publike dhe të angazhohen në dialog.

Pjesëmarrja publike/qytetare

Gazetaria e sotme...

...nuk është më njëkahëshe - përfshin pjesëmarrjen e qytetarëve;

...duhet të nxitë biseda sociale; dhe

...përfiton nga krijimtaria dhe kontributet e njerëzve, po aq sa njerëzit përfitojnë nga gazetaria e mirë.

Roli i mediave sociale

....Një medium që mbështet fushatat mjedisore dhe lidh njerëzit në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë për çështjet kryesore mjedisore, si ndryshimi i klimës.

....Një mjet i rëndësishëm për të siguruar një hapësirë dhe mjete për publikun për të marrë pjesë në ndikimin ose moslejimin e vendimeve mjedisore të marra historikisht nga qeveritë dhe korporatat që na prekin të gjithëve.

....Krijon një mënyrë për njerëzit që të lidhin sfidat dhe zgjidhjet mjedisore lokale me narrativa në shkallë më të gjerë që do të ndikojnë tek ne si një komunitet global.

KAPITULLI V



PLANI LOKAL I VEPRIMIT
NË MJEDIS

KAPITULLI V - PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS {STRUKTURA}

Struktura, për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM-së), për bashkinë, është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Përgatitja e PLVM-së është detyrim i ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, referuar nenit 22 “Planet vendore të veprimit për mjedisin”.

Në hartimin e PLVM-së janë marr në konsideratë parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në bashki.

Mbrojtja e përbërësve të mjedisit fokusohet në: a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit; c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; ç) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; d. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dh) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit; e. mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Autoriteti vendor, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të PLVM-së të integruar dhe me strategjitë, programet, planin e përgjithshëm vendor dhe të projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

Masat për mbrojtjen e mjedisit përcaktohen në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis, duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfuara prej tyre si dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve.

Në këtë kontekst Plani Lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të
- veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas Planit të Veprimit.
- Forcojë bashkëpunimin, koordinimin dhe komunikimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm
- në nivel bashkie dhe njësite të qeverisjes vendore, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve që përfaqësojnë interesa të ndryshme, shoqërinë civile dhe përfaqësues të OJF-ve, biznesin, shkencëtarë, etj., duke përcaktuar aktorët kryesorë dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe të kontributit të tyre në këtë proces.
- Rrisë aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore

- të planit të veprimit të mjedisit, duke vlerësuar dhe prioritetizuar problemet, përcaktuar masat, burimet njerëzore e financiare dhe mundësitë reale të komunitetit, duke organizuar forume dhe përfshirjen e publikut, për hartimin dhe zhvillimin e Planit të Veprimit.
- Nxisë shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve,
- modeleve dhe praktikave me të mira nga plane të mëparshme, nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të përvojave lidhur me
- përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate, monitorime dhe vlerësime efektive që janë thelbësore për një veprim të komunitetit.

Përmbajtja e strukturës së Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM-së)

Të përgjithshme

Përshëndetja e Kryetarit të Bashkisë

Aktorët dhe përgjegjësitë e hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Vendimi i Këshillit Bashkiak për hartimin e PLVM-së.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë për vetëqeverisjen vendore, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të natyrës, etj, të harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur dhe këshilluar për përgatitjen e PLVM-së.

PJESA 1

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është një dokument i politikës mjedisore vendore, i cili paraqet prioritetet mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre, në nivel bashkie. Hartimi i këtij plani, gjithashtu, zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Njëherazi, PLVM-së nxit bashkëpunimin mes shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

1.1 Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është detyrim i ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, referuar nenit 22 "Planet vendore të veprimit për mjedisin", ku:

- a. Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji.
- b. Planet e veprimit, vendore, për mjedisin rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.

c. Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni.

ç. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

1.2 Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin PLVM-së për bashkinë, për një periudhe pesë vjeçare, në mënyrë periodike i cili rishikohet dhe përditësohet në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.

Hartimi i PLVM-së bazohet në strukturën e parapërgatitur dhe të miratuar nga Këshilli Bashkiak (KBa).

Procesi i hartimit ndjek të gjitha procedurat e caktuara në dispozitat e ligjit nr.146, datë 30.19.2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i ndryshuar, përmes organizimit të takime me përfshirjen sa më të gjerë për të marrë mendimet e komunitetit, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore si dhe duke garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në këtë proces.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, për bashkinë, mbështetet në tri drejtime kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga PLVM-së, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë bashkinë.

2. Përcaktimi, listimi dhe prioritizimi i problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zbatimin e aktiviteteve për zgjidhjen e problemeve mjedisore

Është pjesa më e rëndësishme e PLVM-së, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë shërben për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

VIZIONI

Përcaktohet duke marrë mendimin dhe dakordsinë e strukturave përgjegjëse planifikuese, zhvilluese, konservuese, të botës akademike, OShC-ve, të komunitetit, biznesit dhe palëve të interesit. Vizioni mund të jetë për një periudhe kohore jo më pak se 10 vjet.

PJESA 2

II. PROFILI I BASHKISË – Informacion i përgjithshëm

2.1 Historiku i Bashkisë

2.2 Vendndodhja e bashkisë

2.1 Njësitë administrative

Harta. Vendndodhja e bashkisë

2.3 Gjendja e përgjithshme mjedisore

2.4 Karakteristikat e relievit, gjeologjia dhe gjeomorfologjia

2.5 Karakteristikat e rrjetit hidrologjik

2.6 Klima

2.7 Toka

2.8 Përshkrimi i vlerave ekologjike

2.9 Përshkrimi i gjendjes social-ekonomike

- 1.1.1. Aspektet demografike, popullsia, barazia gjinore, papunësia
- 1.1.2. Arsimi
- 1.1.3. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
- 1.1.4. Përdorimi i territorit
- 1.1.5. Pronësia mbi tokën
- 1.1.6. Bujqësia, prodhimet bujqësore, pemëtaria, vreshtaria, ullinjtë, agrumet.
- 1.1.7. Blegtoria dhe prodhimet blegtorale
- 1.1.8. Mbarështimi i bletëve
- 1.1.9. Pylltaria dhe kullota
- 1.1.10. Bimët mjekësore dhe aromatike
- 1.1.11. Gjuetia
- 1.1.12. Peshkimi dhe akuakultura
- 1.1.13. Përdorimi i ujërave
- 1.1.14. Infrastruktura, shërbimet dhe transporti
- 1.1.15. Turizmi, eko-turizmi, veprimtaritë çlodhëse dhe turizmi kulturor
- 1.1.16. Përshkrimi i peizazhit dhe trashëgimisë kulturore, arkitektonike, etnokulturore, shpirtërore
- 1.1.17. Industria, tregtia, zejtaria
- 1.1.18. Edukimi dhe kërkimi shkencor
- 1.1.19. Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit
- 1.1.20. Përdorime të tjera të territorit, minierat, HEC, etj.

PJESA 3

III. GJENDJA E MJEDISIT - VLERËSIMI

3.1 Ajri

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e ajrit

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemit të ajrit.

3.2 Uji

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e ujit

3.2.1 Burimet Ujore

3.2.2 Rrjeti i furnizimit me ujë

3.2.3 Cilësia e ujit të pijshëm dhe monitorimi

3.2.4 Burimet e mundshme të ndotjes së ujit

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve.

3.3 Ujërat e zeza

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e ujërave të zeza

3.3.1 Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza

3.3.2 Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza

Konkluzione dhe Rekomandime për zgjidhjen e problemit me ujërat e zeza.

3.4 Mbeturinat

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e mbeturinave

3.4.1 Llojshmëria e mbeturinave

3.4.2 Vendgrumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave

3.4.3 Trajtimi i mbeturinave

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.6 Ndotja

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e ndotjes

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.7 Zhurmat

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e zhurmave

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.8 Toka

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e tokave

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.9 Erozioni

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e erozionit

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.10 Pyjet, Kullotat dhe Bimët mjekësore

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e pyjeve, kullotave dhe bimët mjekësore

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.11 Zonat e gjelbërta urbane

3.12 Biodiversiteti dhe peizazhi

Gjendja dhe masat e nevojshme për problemet e menaxhimit të biodiversitetit

3.12.1 Rrjeti i zonave të mbrojtura lokale

3.12.2 Trashëgimia natyrore

3.12.3 Tipat e habitateve, Bimësia, Flora dhe fauna

3.12.4 Peizazhi

3.12.5 Monumentet e natyrës

Konkluzione dhe Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve kyçe

3.13 Zhvillimi urban

3.13.1 Plani i përgjithshëm vendor dhe Plani i detajuar vendor

3.13.2 Zhvillimi i infrastrukturës

3.13.3 Zhvillimi i rrjetit rrugor

3.13.4 Zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve

3.13.5 Zhvillimi i rrjetit elektrik

3.13.6 Zhvillimi i rrjetit të komunikacionit

3.13.7 Transporti publik

3.14 Dukuritë natyrore

3.14.1 Zjarri

3.14.2 Ortekët

3.14.3 Erozioni

3.14.4 Përmytjet

3.14.5 Tërmetet

3.15 Ndryshimet klimatike

PJESA 4

VI. METODOLOGJIA E PRIORITIZIMIT

Për të vendosur prioritetet për një periudhën pesë vjeçare duhet bazuar në opinionet, komentet dhe mendimet e shprehura dhe të siguruar në takimet e organizuar me palët e interesit gjatë procesit të punës për hartimin e PLVM-së.

Për problemet kryesore të fushës së mjedisit dhe prioritizimin e tyre mund të kryhen edhe anketime me komunitetin dhe palët e interesit.

4.1 Përcaktoni, listoni dhe prioritizoni problematikat kryesore mjedisore

Hartoni tabelën:

PROBLEMI	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë, fizike dhe njerëzore).	Shkalla e ndikimit	Ndikimi (Paraqet ndikim negative në mjedis, shëndet, mirëqenie etj.).	Prioriteti i matur me shkallën: *Pak i rëndësishëm **Mesatarisht i rëndësishëm ***Shumë i rëndësishëm

PJESA 5

V. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PLVM-së

Prioriteti 1:				
Problemi:				
Aktiviteti	Afati kohor	Struktura përgjegjëse	Kosto000/L	Treguesi i suksesit
A1				
...				

Plani i detajuar për zbatimin e aktiviteteve

Aktiviteti	Viti Parë				Viti Dytë				Viti Tretë				Viti Katërt				Viti Pestë			
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
A1																				
A2																				
....																				

Etj...

BIBLIOGRAFIA:

Literatura e studimet e përdorura për informacionin dhe analizën e dokumentuar në brendësi të këtij plani

SHTOJCAT:

Vendimi i Këshillit Bashkiak (miratimi i dokumentit me shkresë zyrtare nga Këshilli Bashkiak i planit vendor të mjedisit)

Harta, Tabela, Grafikë, Figura, Foto (materiale që lidhen me përmbajtjen e dokumentit dhe statistikat që janë përdorur në të)

DOKUMENTA TË KËSHILLUAR

- Manual për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore – Qendra Rajonale e Mjedisit (REC).
- Raport për njohjen, analizimin dhe përafrimin e legjislacionit të fushës së natyrës në Shqipëri. INCA.
- Vlerësimi i gjendjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri, INCA.
- Analiza e vlerësimit të nevojave të kuadrit rregullator kombëtar me rëndësi për burimet natyrore, përdorimit të zonave të mbrojtura, menaxhimit dhe procesit të vendimmarrjes. INCA.
- Doracak për ndikim në politikat e ruajtjes së natyrës përmes advokim-lobimit efektiv. INCA.
- Fushatbërja e efektshme – si të organizojmë një fushatë të suksesshme mjedisore – manual i përgatitur për OJF-të nga Milieukontakt.
- Vigjilenca mjedisore në praktikë – Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile, EDEN.
- Vlerësimi pasuror i krimeve mjedisore në Shqipëri. EcoAlbania.
- Manuali “Menaxhimi i Problemeve Mjedisore në Nivel Vendor” nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE).
- Vlerësimi Mjedisor në Shqipëri pas Konfliktit. UNEP.
- The Critical Friend: An Effective Local Watchdog. Kageni, A. Reisdorf K.

<https://ctb.ku.edu/en/table-of-contents/advocacy/advocacy-research/act-as-watchdog/main>

<https://advocacyguide.icpolicyadvocacy.org/>

<http://www.who.int/workforcealliance/knowledge/toolkit/33.pdf>

<https://eecso.inca-al.org/article/nxitja-e-vendimmarrjes-transparente-per-menaxhimin-e-burimeve-natyrore-shenime-per-raportimin-e-ceshtjeve-mjedisore/>

<https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2018/05/>

[Advokimi_n%C3%ABp%C3%ABrmjet_medias_dhe_rrjeteve_sociale.pdf](https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2018/05/Advokimi_n%C3%ABp%C3%ABrmjet_medias_dhe_rrjeteve_sociale.pdf)

Projekti zbatohet nga:
Partneri drejtues i projektit:
Instituti per Ruajtjen e Natyres ne Shqiperi



Shoqatat partnere:



Klubi Ekologjik, Lezhë - KEL



Mbrojtja e Mjedisit dhe
Zhvillimi i Turizmit, Hax - MMZNT



Shoqata "Horizont EU", Lushnje

Financuar nga LevizAlbania



Ky projekt i Agjencisë Deletane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SOC



Elizavërishte Edgjenjësia e të
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra

Agjencia Deletore për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SOC

Për më shumë
informacion:

<https://skrbri@inca-al.org/sq/>
Adresa: Rruga Ismail Alla,
Pallati IVEA, kat. Iro, Tiranë

Tel/Fax: +355 42231437
www.inca-al.org
e-mail: info@inca-al.org

Ky botim u realizua me mbështetjen e LevizAlbania.
Hendimet dhe opinione të shprehura në të i përketin autorëve dhe
nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e LevizAlbania